



DRITA ISLAME

Botim i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë / Çmimi: 250 Lekë / www.dritaislame.al

Viti XXXV / Nr. 02 / Shkurt 2026



Me devotshmëri
DREJT ZOTIT TIM



“DRITA ISLAME”

**Botim i Komunitetit Mysliman
të Shqipërisë**

www.dritaislame.al

DREJTOR

Dorian Demetja

KRYEREDAKTOR

Mehmet Disha

DIZAJNI DHE FAQOSJA

Erzen Carja

KONTAKT:

Tel/fax +355 68 87 71 655

E-mail: mehmet.disha@kmsb.al

Viti XXXV i botimit

Nr. 02 (512)


Shkurt, 2026


ISSN 2226-7115

*Artikujt
që vijnë në redaksi
dhe botohen, nuk
paraqesin domosdoshmërisht
edhe pikëpamjet e revistës.*



www.dritaislame.al





editorial

04 Agjërimi, hytbe e Pejgamberit a.s. mbi rëndësinë e Ramazanit / Editorial

në fokus

06 Agjërimi dhe dobisë e tij
H. Bujar Spahiu

10 Dy sy që nuk do ta shohin zjarrin e xhehenemit
Tauland Bica

lajme / aktivitete

12 01-Përfundoi me sukses edicioni i dytë i konkursit kombëtar të kuranit në shqipëri
02-Frytet e besimit ndalen në Berat
03-Zhvillohen frytet e besimit në Kavajë
04-Mbrëmje fetare në xhaminë e Et'hem Beut me rastin e natës së Beraetit

refleksione

16 Fitër Bajrami, festë dhe inkurajim për angazhime të mëtejshme / Dorian Demetja

çështje fetare

18 El-ihitjaru li ta'lli-l-muhtari vepër themeltare e fikhut hanefi / Sabri Bajgora

familja

20 Gruaja dhe Ramazani, drita që agjëron në heshtje
Jonida Cikalleshi

horizonti i besimit

22 Vlera dhe rëndësia e natës së Kadrit
Nasuf Hoxha

24 A mund të marrin hoxhallarët dhurata?
Bediuzzaman Said Nursi

26 Duar që zgjaten drejt meje
Rovena Xhili

28 Zekati dhe Sadakaja e Fitrit
Gentian Mara

bota shpirtërore

32 Ademi (a.s) si filloi jeta në tokë
Redaksia

hapësirë femërore

36 Letra e Ajnshtajnit për të bijën, Lieserl: Dashuria është gravitet / Hapësirë Femërore

këndi i poezisë

38 Për ty Allahu mjafton
Arjola Zaçi



Agjërimi

**Hytbe e Pejgamberit a.s. mbi
rëndësinë e Ramazanit**



Tregohet prej Selman Farisiut se H. Muhamedi a.s. mbajti një hytbe në fund të muajit Shaban mbi rëndësinë e muajit Ramazan, ku, midis të tjerash, tha:

“O njerëz, po ju vjen një muaj i madh dhe i bekuar, muaji në të cilin gjendet një natë më e mirë se njëmijë muaj. Është një muaj që Zoti e ka bërë farz (detyrim) agjërimin e ditës, namazet e teravive-namazet e natës në të – vullnetare. Çdo vepër e mirë në këtë muaj, është e njëjtë me atë që ka kryer një detyrë farz, jashtë këtij muaji. Ndërsa ai që kryen një detyrë, domethënë një farz në këtë muaj është i barabartë me 70 farze, që i kryen jashtë këtij muaji.

Ramazani është muaji i sabrit (durimit), kurse shpërblimi i sabrit është xheneti. Ramazani është muaji i bamirësisë, muaji në të cilin shtohet bereqeti i besimtarit të vërtetë. Kush e fton tjetrin në iftar, do t’i falen gjynahet, do t’i shpëtojë zjarrit të xhehenemit dhe do të ketë shpërblim të barabartë me atë që e ka ftuar në iftar pa asnjë pakësim të shpërblimeve të veta.”

Sahabet i thanë Profetit se disa nga ata nuk kishin mundësi për këtë. I dërguari i Allahut u përgjigj: “Allahu do të shpërblejë me shpërblimin e përmendur, cilido që e fton për iftar agjëruenin edhe me një hurmë, apo një gotë qumësht, ose qoftë edhe me një gotë ujë”.

Ky është një muaj, fillimi i të cilit është mëshirë, mesi është falje, ndërsa fundi i tij është shpëtim prej zjarrit të xhehenemit.

Në këtë muaj përpikuni të plotësoni katër veti: me dy prej tyre do të kënaqni Allahun dhe dy të tjerat ju nevojiten juve. Të parat, me të cilat do të kënaqni Allahun janë: Dëshmia e shehadetit, se nuk ka Zot tjetër përveç Allahut dhe lutje për të kërkuar falje prej të madhit Zot për mëkatet e bëra.

Dy të tjerat janë: lutje për Zotin që të shpërblejë me xhenet dhe lutje që të ruajë prej xhehenemit.

Kush e ushqen agjëruenin në këtë muaj, Allahu do t’i japë nga burimi i vet, pas së cilës nuk do të ndiejë as etje, as uri, deri kur të hyjë në xhenet.

O popull, Ramazani ju ka ardhur me

bereqet, mëshirë për falje, ky muaj është më i dashur për Allahun nga të gjithë të tjerët, orët e tij janë më të mira nga të gjitha orët e tjera.

Ky është një muaj në të cilin jeni të ftuar te Zoti në mikpritje, ku konsideroheni njerëz të mirë të Allahut xh.sh.

Frymëmarrja juaj në këtë muaj është tesbih, gjumi është ibadet; puna juaj gjatë këtij muaji do të pranohet tek Allahu dhe lutja juaj do të plotësohet.

Kërkoni nga Zoti juaj sinqerisht dhe me gjithë zemër që t’ju ndihmojë në agjërimin tuaj, të cilin jua ka bërë detyrë dhe lexoni Kuranin që ju ka shpallur.

I paaftë do të jetë ai që në këtë muaj nuk përfiton nga mëshira dhe falja e të madhit Zot. Derisa jeni të uritur e të etshëm, atëherë përkujtoni urinë e etjen e Ditës së Gjykimit.

Jepuni lëmoshë – sadaka atyre që janë të varfër dhe të shkretë, nderoni më të vjetrit dhe kini mëshirë ndaj të rinjve, respektoni dhe vizitoni farefisën.

Ulini sytë prej asaj që i ndalohet besimtarit ta shikojë dhe mos dëgjoni atë që besimtari e ka të ndaluar ta dëgjojë.

Kini mëshirë ndaj të tjerëve që Zoti të ketë ndaj jush. Kërkoni prej Zotit që t’ju falë mëkatet. Ngrini duart lart duke kërkuar prej Allahut me dua pas çdo namazi, se kjo është koha më e mirë për dua dhe Allahu i mbulon njerëzit e vet me mëshirë dhe pranon duatë që i drejtohen.

O popull, shpirtrat tuaj janë varur prej veprave tuaja, çlironi shpirtrat duke kërkuar falje prej mëkateve! Shpirtrat tuaj janë ngarkuar me barrë të rënda, lehtësojini peshën me sexhde sa më të gjatë. Dijen se do të jeni më se të sigurt, se Zoti nuk do t’i mundojë ata që falen dhe bëjnë sexhde dhe nuk do t’i frikësojë me zjarr të xhehenemit.

Kur të vijë nata e parë e Ramazanit thërret një thirrës (prej anës së Zotit): O ti që kërkon mirësi, pranoji ato, dhe o ti që kërkon të liga, ndalo! Shpëtimin nga zjarri i xhehenemit e bën vetëm Allahu për çdo natë.”

Kjo hytbe paraqitet sipas tregimit të Ebu Hurejres.

AQJËRIMI DHE DOBITË E TIJ



Muaji i Ramazanit është periudhë ku Allahu i shumëfishon shpërblimet për agjëruesit dhe i ngre ata në shkallët e larta të devotshmërisë. Me agjërimin e Ramazanit më së miri shprehet besimi, sinqeriteti, humaniteti, uniteti, solidariteti, virtyte këto të cilat duhet të stolisin çdo besimtar. Me anë të agjërit në këtë muaj, arrijmë të krijojmë jetë më të ngritur shpirtërore, një atmosferë mirëkuptimi, mirësjelljeje, devocioni, një atmosferë bujarie, ndershmërie dhe përgjegjësie, duke i pranuar gabimet dhe duke kërkuar faljen e Zotit. Profeti Muhamed a.s. thotë: "Gjumi i agjëruesit vlerësohet si adhurim, kurse heshtja si tesbih (madhërim i Zotit). Mirësive dhe adhurimeve të tij u jepet shpërblim shumëfish. Allahu ia pranon lutjet dhe ia fal mëkatet" (Kenzu'l-Umal, 3/327).

Dobitë e agjërit do t'i trajtojmë në disa këndvështrime, të cilat do të shtrihen në planet si më poshtë:

- a) Në aspektin shpirtëror
- b) Në aspektin moral dhe shoqëror

Në aspektin shpirtëror dhe të edukimit të egos

Agjërimi i Ramazanit është nga pikat e para të themeleve të besimit në fenë Islame. Ai ka disa anë të dobishme sidomos në aspektin shpirtëror, edukimit të nefsit (egos, unit), si dhe për të shprehur falënderimin ndaj Allahut për mirësitë që na ka dhënë.

Njerëzit, nën perden e pakujdesisë të të mirave materiale, nuk arrijnë të vlerësojnë dhe të çmojnë të mirat e Allahut xh.sh. Zoti me urdhrin e agjërit të Ramazanit, i shtyn besimtarët të vihen si në pozitën e një ushtrie. Ai i fton besimtarët të marrin pjesë në një adhurim dhe festë të amshueshme. Ata dalin dhe presin ftesën e iftarit me fjalën e ezanit të akshamit, duke thënë: "Allahu-Ekber!" Përkundrajt kësaj situate të bukur të Mëshirës së gjerë të të Gjithëmëshirshmit, besimtarët përgjigjen me një rregullsi dhe përsosmëri të shkëlqyer. Të gjithë besimtarët në momentin e iftarit, përpara sofrës presin urdhrin e Krijuesit të Madhëruar.

Nuk mund të merret me mend se sa çmënduri është të shpërblesh shërbëtorin për arsye se ka sjellë dhurata nga mbreti, duke mos vlerësuar atë që i ka dërguar,

si dhe në mënyrë të pakujdesshme t'i nënvlerësosh ato, kur dihet që ato dhurata kanë vlerë të jashtëzakonshme. Pra, duhet pranuar se Allahu i Madhëruar, përballë mirësive që ka ekspozuar në faqen e tokës, kërkon falënderime nga njerëzit. Duhet ta falënderosh Atë, duke i pranuar mirësitë drejtpërdrejt dhe duke e ditur se kush është Pronari i vërtetë, në mënyrë që të përcaktosh vlerën e tyre.

Nefsi i njeriut nga pakujdesia e harron vetveten, sepse mban dobësinë, varfërinë e pafundme dhe paaftësitë e panumërta. Ai nuk do që t'i shohë ato dhe ta kuptojë se është një i varfër që mund të shkojë drejt zhdukjes. Ky është edhe thelbi i fatkeqësisë, sepse ai është një krijesë që është krijuar prej mishi dhe kocke, që do të priset së shpejti dhe do të ndahet. Ai mendon se ka një trup prej çeliku, që kurrë nuk do të zhduket, prandaj sulet pas interesave të kësaj bote, duke imagjinuar se nuk do të vdesë. Me një ambicie të tmerrshme dhe me një lidhje të fortë pas kësaj bote, bën çdo përpjekje. Tërhiqet pas çdo gjëje që është e shijshme dhe e vlefshme, duke e harruar Krijuesin që e edukon me mëshirën e pasosur. Më në fund rrokulliset në moralin e keq, duke mos menduar për përfundimin e jetës, sepse edhe ai do të vdesë një ditë dhe do të ikë në jetën e përjetshme. Agjërimi i Ramazanit u tregon dobësinë mosmirënjohësve, varfërinë dhe pakujdesinë e tyre. Për shkak të urisë ata mendojnë stomakun dhe e pranojnë nevojën e tij. Me anë të urisë së agjërit, njeriu e kujton se sa mashtrues është trupi i tij dhe e pranon se ka nevojë për Mëshirën e Allahut xh.sh. Uria e shtyn të braktisë idhujtarinë e nefsit dhe të pranojë dobësinë dhe varfërinë e tij. Në këtë mënyrë i zgjohet dëshira që të mbështetet në praninë e Allahut xh.sh.

Ramazani është një model ekspozite dhe shumë fitimprurës për jetën e përjetshme. Për të mbledhur prodhimet e jetës tjetër, ai është si shiu i prillit në pranverë. Prandaj, ndaj mirësive të Zotit xh.sh, është si një festë dhe parakalim zyrtar. Ky është shkak i arsyeshëm për t'i urdhëruar myslimanët të agjërojnë Ramazanin dhe të mos i shtojnë pakujdesitë. Të mos jenë të pangopur ndaj ushqimit dhe pirjes, larg nevojave kafshërore dhe orekseve të papëlqyera. Kështu urdhërohen që për një

kohë të shkurtër të braktisin veset kafshërore dhe t'u shëmbëllojnë engjëjve të pamëkatë. Ndoshta njeriu duhet ta mendojë se ka hyrë në tregtinë e jetës tjetër, për të mbledhur prodhimet e saj, prandaj le të bëhet njeri i pamëkatë për një farë kohe. Shpirtërisht le t'i braktisë nevojat, duke pranuar dobësinë dhe varfërinë e vet.

Shpesh herë një mbret i famshëm, disa ditë të vitit i zgjedh për vetveten si ditë feste apo kuvendi dhe shtetasit e posaçëm të vet i njeh me ligje të veçanta, ndoshta dhe u fal dhurata të veçanta, duke qëndruar përballë njëri-tjetrit pa kurrfarë perdeje, ashtu siç u ka hije shtetasve besnikë. Po kështu edhe Sunduesi i Pafillimtë dhe i Pambarimtë, mesazhin më të madh dhe më të përsosur neve na e ka zbritur në muajin e Ramazanit. Kjo është edhe arsyeja që Ramazani bëhet si festë e veçantë për Allahun xh.sh. dhe shndërrohet në një ekspozitë të madhe të Edukatorit të Vërtetë.

Me agjërimin e Ramazanit njeriu mësohet të mbajë dietë. Kështu nefs i mësohet t'i bindet urdhrave dhe stomaku i dobët e fatzi shpëton nga pesha e rëndë e bluarjes, i cili bëhet shkak që njeriu të sëmuret shpesh. Njeriu gjatë Ramazanit disiplinohet, që ai të mos i sulet haramit duke braktisur hallallin. Ramazani e mëson njeriun ta kuptojë se qëllimi i krijimit të tij është të mos e shkatërrojë jetën shpirtërore.

Agjërimi i Ramazanit është një lloj ushtrimi, që ia kalit durimin njeriut. Ai zgjat rreth pesëmbëdhjetë orë në ditë dhe po të mos hahet syfy, njëzetekatër orë. Pra, për të kalitur durimin, ky është një ushtrim shumë i mirë dhe një ilaç për atë që nuk duron dot fatkeqësinë dhe nuk ka rezistencën e duhur. Profeti a.s. thotë: "Agjërimi është gjysma e durimit, kurse pastërtia është gjysma e besimit" (Tirmidhi, Daavat, 85; Ibn Maxhe, Sijam, 44; Ahmed, 4/260). "Fabrika" e stomakut (lukthit) ka shumë anë shpirtërore, sepse pajisjet e saj kanë kontakt me vetë njeriun. Po qe se nefs i nuk e duron urinë e një muaji, atëherë sundimin e merr në dorë ai dhe bëhet shkaktari i veseve të tjera, duke u dhënë pas tij dhe duke harruar detyrat e adhurimit.

Në Ramazan myslimanët shpirtërisht

përparojnë në shkallë të ndryshme dhe sipas meritave fitojnë gëzime, qetësi dhe lehtësira të zemrës. Zemra, shpirti, mendja dhe sekretet e shqisave të besimtarëve në Ramazan përsosen dhe fitojnë shumë ngushëllime shpirtërore.

Pikësnyimin kryesor agjërimi i Ramazanit e ka të thyjë faraonësinë dhe imagjinatën prej idhullit të nefsit, duke i bërë të njohur atij dobësinë, varfërinë e pafuqinë, në mënyrë që të fillojë të kryejë adhurimin ndaj Krijuesit të tij. Ai e njofton se është një rob dhe asgjë më tepër.

Në aspektin moral dhe shoqëror

Agjërimi është lartësim i shpirtit, ushtrim për përforcimin e trupit dhe nxitës për bamirësi. Ai synon ngritjen e ndërgjegjes së individit, ndriçimin e mendjes dhe zbardhjen e zemrës. Ai është një institucion edukativo-moral, i cili synon edukimin fizik e shpirtëror të njeriut ku e përgatit atë përballë sprovave me të cilat ballafaqohet në jetën e përditshme. Nëpërmjet agjërit njeriu aftësohet për të disiplinuar dëshirat e tij dhe ka vullnet e fuqi për të kryer çdo punë me përpikëri. Ai përsos aftësinë fizike dhe lartëson virtytet morale duke kultivuar të përshtaturit me kushtet e ndryshme social-ekonomike të jetës së përditshme. Duke agjëruar njeriu mënjanon me ndërgjegje ushqimin sipas orarit të caktuar në agim dhe në perëndim të diellit, largon mendimet dhe sjelljet e pahijshme dhe shton ndjenjën e tolerancës aq të nevojshme për shoqërinë ku jetojmë, duke kontribuar kështu për harmonizimin e raporteve në familje, punë dhe shoqëri.

Devotshmëria është qëllimi i vërtetë i agjërit dhe nëse e kuptojmë dhe e pranojmë si qëllim kryesor, atëherë më pas, do të gjejmë të gjitha frytet dhe dobët e tij. Objektivi final i agjërit është mirëqenia e njeriut dhe lumturia e tij në të dy botët.

Të privosh vetveten nga gjërat thelbësore të jetës, nuk është një akt i lehtë. Kjo kërkon një personalitet të fortë për të pasur një vetëkontroll, vetëdisiplinë dhe vetëpërmbytje. Ky program vetushtrues gjatë muajit të Ramazanit, ka rëndësi të veçantë në jetën e përditshme. Një besimtar që mund të përmbajë veten nga gjërat

thelbësore të jetës për një kohë të caktuar dhe kur këtë e bën për hir të dashurisë për Allahun, meriton një shpërblim nga vetë Krijuesi. Profeti Muhamed a.s. ka thënë: "Ka shumë njerëz që agjërojnë, e nga kjo nuk kanë asgjë, përveç urisë dhe etjes. Ka shumë njerëz që luten natën, e asgjë nuk ka nga kjo lutje, përveç pagjumësisë, i këtillë është çdo njeri, i cili nuk e kryen këtë veprim me besnikëri dhe sinqeritet të plotë." (Ibn Maxhe, Sijam, 21).

Gjatë agjërit myslihanët mësohen të kontrollojnë emocionet e tyre dhe të kenë durim ndaj të gjitha llojeve sprovave e shqetësimeve. Agjërimi është mjeti më i mirë për rrënjosjen e moralit. Përsosmëria e tij më e madhe është se ashtu siç na largon nga nevojat e stomakut, na pastron edhe nga zilia e shqisave; syri, veshi, gjuha, zemra apo mendimet e liga të imagjinatës. Domethënë secilës shqisë i ndalohet të ndërhyjë në shijime të ndaluara dhe të padobishme. Për shembull, syrin e ndalon nga vështrimi i haramave dhe nga lëvizjet në vende të dyshimta, kurse veshin e drejton të mos dëgjojë fjalët e liga, por Kur'anin dhe fjalët e drejta. Në këtë mënyrë edhe shqisat e tjera i shtyn të agjërojnë në këtë muaj të bekuar.

Gjatë agjërit urrejtja dhe zemërimi personal janë në nivelin më të ulët. Myslihanët mbajnë parasysh këshillat e të dërguarit të Allahut: "Po qe se, ndërsa jeni të agjëruar, dikush ju ofendon ose ju godet, thojini: Unë jam me agjërim" (Buhari, Saum, 2; Muslim, Sijam, 161). "Zoti nuk ka nevojë që njeriu të braktisë ushqimin dhe pijen, nëse ai nuk braktis fjalën e keqe dhe veprën e ligë" (Buhari, Saum, 8;). Për këtë arsye Profeti a.s. e quan agjërimin mburojë, sepse mbron zemrën nga ligësitë dhe gjymtyrët nga veprat e shëmtuara. Nëpërmjet agjërit njeriu vlerëson të mirat e kufizuara që i ka dhënë Zoti. Kështu, ai bëhet i thjeshtë, i sinqertë dhe mirënjohës ndaj Allahut të Madhëruar.

Islami i shikon interesat e shoqërisë mbi interesat e individit. Shërbimi ndaj Zotit bëhet nëpërmjet një jetë të pastër në shumëllojshmërinë e shoqërisë. Zoti ka krijuar njerëzit me kapacitete të ndryshme fizike, emocionale, intelektuale

dhe shpirtërore. Ai na ka bërë të gjithëve ne të kemi nevojë për njëri-tjetrin për përfitime të dyanshme. Nga kjo, nënkuptohet që Ramazani dhe respektivisht agjërimi ka rëndësi sociale, se secili person kërkon me veprimet e tij të dalë në dritë e gjithë shoqëria Islame, duke u bërë kështu të devotshëm, të mirëorganizuar dhe të mirëdisiplinuar. Pra, kjo shoqëri myslimane në këtë muaj, jeton dhe punon sipas kodit hyjnor moral të shkruar në Kuranin e Shenjtë që ka zbritur në këtë muaj.

Falë agjërit të Ramazanit, në jetën shoqërore njeriu krijon lidhje të ndryshme me njerëzit e tjerë. Me këtë, ai ndjen një lidhje të fuqishme ndaj tyre. Bashkë me të gjithë besimtarët, fillimi i agjërit në të njëjtin çast, pritja e iftarit, ngritja në syfyr, falja e teravive me xhemat, gdhirja e natës së kadrut, hyrja në bajram etj., bëhen shkak për një vëllazëri shumë të shëndoshë dhe për një dashuri të vërtetë. Kështu, besimtarët bëhen si gjymtyrë të një trupi të vetëm, ashtu siç shprehet edhe Profeti ynë: "Në dashurinë për njëri-tjetrin, në dhimbjen për njëri-tjetrin dhe në dhembshurinë për njëri-tjetrin, besimtarët janë si një trup i vetëm. Po qe se një organ ankohet, organet e tjera rrinë pa gjumë e rënkojnë" (Buhari, Edeb, 27; Muslim, Birr, 66; Ahmed b. Hanbel, 4/270). Me këtë mendim të lartë, në shoqëri ngrihen bashkimi dhe uniteti.

Pritja e iftarit rreth sofrës nga të gjithë pjesëtarët e familjes së bashku, pra pritja nga secili prej tyre veç e veç të të njëjtës gjë në një kohë, i lidh më shumë këta njerëz me njëri-tjetrin. Kjo situatë e pritjes së iftarit është shumë e rëndësishme sidomos për shtimin e afërsisë dhe dashurisë mes individëve të familjes, domethënë për realizimin e ngritjes së familjes mbi themele më të shëndosha. Kjo duhet të jetë edhe njëra prej urtësive të faktit që Islami kërkon që e gjithë familja të ulet së bashku në sofrën e iftarit dhe ashtu ta presë atë. Pritja e iftarit i hap rrugë forcimit të lidhjeve të afërsisë dhe dashurisë sa mes pjesëtarëve të familjes, aq dhe me anë të ftesave, mes të ftuarve, të njohurve, miqve, madje edhe të panjohurve fare.

DY SY QË NUK DO TA SHOHIN ZJARRIN E XHEHENEMIT

"Ibn Abbasi (r.a) transmeton: E kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut ﷺ duke thënë: 'Janë dy sy që zjarri i Xhehenemit nuk do t'i prekë; syri që qan nga frika e Allahut dhe syri i ushtarit që e kalon natën në gadishmëri.'"
(Tirmidhi, Fedail el-Xhihad, 12)

I Dërguari i Allahut ﷺ, në këtë hadith, përmend njëkohësisht dy forma të xhihadit. Xhihadi i parë është xhihadi material dhe i vogël, i cili realizohet në kufij ose në fushëbeteja, ku njeriu, në momentet më të rrezikshme, qëndron roje duke hequr dorë nga gjumi. Syri i një personi që kryen një xhihad të tillë nuk do të ekspozohet ndaj zjarrit të Xhehenemit.

Forma tjetër është xhihadi shpirtëror dhe madhor, të cilin e përfaqëson syri që derdh lot nga frika dhe përlësia ndaj Allahut. Po, të dy këto sy, si ai i xhihadit material, ashtu edhe ai i xhihadit shpirtëror, nuk do ta shohin Xhehenemin dhe as dënimin e tij.

Ashtu siç është e pamundur që qumështi i dalë nga gjiri të kthehet sërish pas, po aq e pamundur është që syri që qan nga frika e Allahut të hyjë në Xhehenem. Gjendja e një njeriu që, në rrugën e Allahut, mbetet i mbuluar me pluhur

e baltë, nuk ndryshon nga kjo. Sepse i Dërguari i Allahut ﷺ ka theksuar në shumë hadithe se ky pluhur dhe kjo baltë nuk do të bashkohen kurrë me zjarrin e Xhehenemit.

Syri që dridhet dhe qan nga frika e Allahut, syri i atyre që vëzhgojnë vendet nga mund të vijë armiku, që qëndrojnë roje, që mbajnë vigjilencë të vazhdueshme, që bëhen mburojë përballë fatkeqësive që mund t'i bien vendit, që themelojnë institucione dhe që heqin dorë nga komoditeti dhe kënaqësia e jetës, të gjithë këto sy nuk do ta shohin zjarren e Xhehenemit. Në këtë kuptim, ata që e reduktojnë xhihadin në një aktivitet thjesht diskursiv, duke u mjaftuar me polemika dialektike sa andej-këndej nën pretendimin se "po i shpjegojnë gjërat popullit", nëse nuk e kontrollojnë se në çfarë mase i zbatojnë vetë ato që predikojnë, në të vërtetë vetëm sa humbin kohë dhe mashtrojnë vetveten. Ndërhyrjet e jashtme të njerëzve që nuk kanë arritur ta disiplinojnë veten, që nuk e kanë thyer hundën e hipokrizisë, që nuk e kanë shtypur krenarinë nën këmbë dhe që nuk kanë hequr dorë nga urdhërimi i të tjerëve dhe nga shfaqja për sy e faqe, nuk do të prodhojnë tjetër veçse shqetësim dhe zhurmë pa përmbajtje reale.

Nga ana tjetër, ata që e trajtojnë çështjen vetëm si xhihad



shpirtëror, duke thënë "pa e fituar betejën time personale nuk është e drejtë të merrem me të tjerët" dhe tërhiqen në një qoshe të tyre, duke e konsideruar ngritjen shpirtërore individuale mbi gjithçka tjetër dhe duke mos marrë pjesë në përpjekjen e përmirësimit të pjesës tjetër të shoqërisë, në fakt, për ta thënë me shprehjen më të butë, me vetëdije apo pa vetëdije, kanë rënë në një kurth për ta jogëzuar Islamin, duke ia zbutur dhe relativizuar adhurimet.

Në disa prej këtij grupi të dytë mbizotëron ky mendim: "Delet varen nga këmbët e tyre, po ashtu edhe dhitë nga këmbët e tyre. Ai që nuk është në gjendje të shpëtojë veten, nuk mund të shpëtojë as të tjerët; prandaj njeriu duhet të përpikët fillimisht të shpëtojë vetveten." Mirëpo, ata që mendojnë kështu, para së gjithash, duhet ta dinë se pikërisht ditën kur njeriu mendon se e ka shpëtuar veten e tij, ai ka rënë në vorbullën më të thellë dhe më të pashpëtueshme. Në të vërtetë, si mund të pretendojë dikush se ka shpëtuar veten? Ndërkohë, Kur'ani urdhëron: "Adhuro Zotin tënd derisa të të vijë e sigurtja (vdekja)" (Hixhr, 99). Kjo do të thotë se askush, derisa të hapet perdja dhe nga bota tjetër t'i thuhet "tani hyr", nuk mund të qëndrojë larg asnjë veprimi që përfshihet në kuptimin

e adhurimit. Njeriu është i obliguar me adhurim deri në frymën e fundit të jetës së tij.

Në këtë gjendje, si mund të jetë e mundur që një njeri, i cili vazhdon të mbetet i ngarkuar me përgjegjësi fetare, të pretendojë se e ka shpëtuar veten? Prandaj, përballja e njeriut me nefsin e tij, përpjekja me veset e këqija që gjenden brenda tij dhe përpjekja për vetë-përmirësim do të vazhdojnë deri në fund të jetës.

Ne jemi të detyruar të jetojmë një jetë të mbështetur në frikë (hauf) dhe shpresë (rexha). Të qenit i sigurt për përfundimin nuk i shkon për shtat asnjë besimtari. Po ashtu, edhe dëshpërimi nuk mund të jetë cilësi e besimtarit. Megjithatë, ana e frikës duhet të mbizotërojë. Edhe një njeri si Omeri (r.a.), teksa po përjetonte çastet e fundit të jetës së tij, ishte në ankth. Mirëpo, dëshmia e mirë e Ibn Abbasit për të dhe fjala e tij: "Unë do të dëshmoj në ahiret se ti je një njeri i mirë", në një farë mënyre e kishte çliruar atë nga ky shqetësim. A nuk thuhet në Kuranin Famëlartë: "Allahu i Madhërishëm i premtonte dy Xhenete atij që i frikësohet madhështisë së Zotit të tij". (Rahman, 46)?!

01 PËRFUNDUI ME SUKSES EDICIONI I DYTË I KONKURSTIT KOMBËTAR TË KURANIT NË SHQIPËRI



Në ambientet e "Tirana International Hotel", u zhvillua ceremonia përmbylëse e Edicionit të 2-të të Konkursit Kombëtar të Kuranit, organizuar nga Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, në bashkëpunim me Ministrinë e Çështjeve Islame, Thirrjes dhe Udhëzimit të Mbretërisë së Arabisë Saudite, përmes Zyrës së Atasheut Fetar të Ambasadës Mbretërore Saudite në Sarajevë.

Në këtë ceremoni, ishin të pranishëm: Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, Ambasadori i Mbretërisë së Arabisë Saudite në Republikën e Shqipërisë, z. Fajsal bin Ghazi Hifdhi, Atasheu Fetar i Mbretërisë së Arabisë Saudite në Sarajevë, z. Abdul-Latif bin Nasir el-Husejn, ambasadorë të vendeve mike të Lindjes së Mesme në Tiranë, myftinj, imamë, të rinjtë pjesëmarrës në këtë konkurs dhe familjarë të shumë të tyre.

Në këtë edicion morën pjesë 120 garues të grupmoshave të ndryshme nga Shqipëria, duke dëshmuar se Kurani mbetet i gjallë në zemrat e rinisë dhe një burim shprese për të ardhmen.

Urime të gjithë fituesve dhe falënderime për komisionin e jurisë, stafin organizator dhe të gjithë ata që kontribuan në realizimin e kësaj veprimtarie të bukur.



02 FRYTET E BESIMIT NDALEN NË BERAT



Xhamia Mbret në qytetin e Beratit mirëpret, në një atmosferë të ngrohtë vëllazërore, ciklin e mbrëmjeve fetare “Frytet e Besimit”.

Aktiviteti u çel me fjalën hapëse të Myftiut të Beratit, z. Bilbil Talla, i cili fillimisht falënderoi besimtarët e pranishëm për pjesëmarrjen. Më pas, ai u ndal shkurtimisht në vlerat fetare, vëllazërore dhe ato morale që përcillen në mexhlise të tilla, ku lartësohet Allahu Fuqiptotë.

Fill pas tij, fjalën e mori z. Erjol Haxhiu – Drejtor i Thirrjes dhe Mesazhit Islam në Komunitetin Mysliman të Shqipërisë, i cili ndau me të pranishmit pendimin e sinqertë dhe dobitë e tij të shumanshme në aspekte të ndryshme të jetës së besimtarit.

Më tej, Myftiu i Kavajës, z. Besnik Leçini, theksoi kujdesin e shtuar që duhet të tregojmë në periudhën kohore në të cilën ndodhemi, si një parapërgatitje e denjë për muajin e bekuar të Ramazanit që po afron.

Së fundmi, z. Shpëtim Seranaj – Drejtor i Marrëdhënieve me Besimtarët në KMSH, ndau me të pranishmit këshilla të vyera mbi vëllazërinë dhe gjallërinë në aspektin e aktiviteteve fetare që duhet të karakterizojnë xhamitë tona, e më pas këto vlera të pasqyrohen edhe në familje, punë dhe shoqëri.



03 ZHVILLOHEN FRYTET E BESIMIT NË KAVAJË



Mbrëmjen e djeshme u zhvillua aktiviteti fetar në kuadër të ciklit “Frytet e Besimit”, i cili u mbajt pas namazit të akshamit në Xhaminë Kubelie, Kavajë, me pjesëmarrjen e besimtarëve të zonës.

Programi u hap me fjalën përshëndetëse të z. Besnik Leçini, Myfti i Kavajës, i cili uroi mirëseardhjen të pranishmëve dhe theksoi rëndësinë e këtyre takimeve fetare si hapësira reflektimi dhe përgatitjeje shpirtërore për besimtarët.

Më pas, z. Lauren Luli, Nënkrjetar i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, foli mbi muajin Shaban si një periudhë parapërgatitore për “maratonën” e adhurimeve që pasojnë në muajin e bekuar të Ramazanit, duke vënë theksin tek ndërgjegjësimi dhe përgatitja graduale shpirtërore.

Në vijim, z. Erjol Haxhiu, Drejtor i Thirrjes dhe Mesazhit Islam pranë KMSH-së, trajtoi temën e vlerësimit të kohës, rëndësinë e Natës së Beraetit, si dhe domosdoshmërinë e pastrimit të zemrës si bazë për një adhurim të sinqertë dhe të pranuar.

Ndërsa z. Shpëtim Seranaj, Drejtor i Marrëdhënieve me Besimtarët pranë Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, foli për ndërtimin e atmosferës së Ramazanit në familjet dhe shtëpitë tona, duke theksuar rolin e prindërve dhe mjedisit familjar në kultivimin e vlerave fetare.

Në përfundim të kësaj mbrëmjeje, u hodh shorti për një Umre dhuratë nga Myftinia e Kavajës, ku një nga besimtarët e pranishëm pati mundësinë të përzgjidhej për të udhëtuar drejt vendeve të shenjta, për të kryer këtë adhurim të veçantë.



04 MBRËMJE FETARE NË XHAMINË E ET'HEM BEUT ME RASTIN E NATËS SË BERAETIT



Në kuadër të natës së Beraetit, në Xhaminë historike të Et'hem Beut, ditën e djeshme u zhvillua një mbrëmje e ngrohtë fetare, e cila mbledhi besimtarë të shumtë në një program të pasur me lexim Kurani, ligjërata, ilahi dhe lutje të përbashkëta.

Ky program u çel me leximin e disa ajeteve Kuranore nga hafizi Enes Hyka, duke krijuar një atmosferë reflektimi dhe qetësie shpirtërore.

Më pas, imami i kësaj xhamie, z. Elton Karaj, përshëndeti të pranishmit dhe u ndal në veçoritë dhe rëndësinë e natës së Beraetit, si dhe në domethënien e veçantë të muajit Shaban në jetën e besimtarit.

Në vijim, Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, mbajti ligjëratën e rastit mbi rëndësinë e angazhimit fetar gjatë muajit Shaban, duke theksuar domosdoshmërinë e përgatitjeve shpirtërore dhe morale për një pritje sa më të denjë në aspektin personal të muajit të bekuar të Ramazanit.

Programi u zhvillua më tej me Ilahi të ndryshme nga Abdulla Ziba dhe Ramazan Karpuzi dhe u mbyll me një lutje të përbashkët për mëshirë, falje dhe begati për të gjithë besimtarët, drejtuar nga imami i xhamisë z. Karaj.



Fitër Bajrami, festë dhe inkurajim për angazhime të mëtejshme

Bajrami i Ramazanit nis me përfundimin e agjërimit njëmuajor të Ramazanit dhe vazhdon tri ditë. Quket ndryshe edhe Bajrami i Madh apo Fitër Bajrami, meqë gjatë Ramazanit jepet sadakaja e fitrit, për begatitë dhe mirësitë e falura nga Allahu gjatë këtij muaji dhe si kompensim për mangësitë që mund të ketë pasur besimtari gjatë këtij adhurimi të veçantë. Fitër Bajrami shënon kohën kur hiqen kufizimet e disa prej begative, që për një muaj ishin të ndaluara, për një kohë të caktuar, duke iu rikthyer tashmë normalitetit.

Besimtari mysliman gjatë Ramazanit shijoi një jetë të disiplinuar, që është bazë për ecurinë dhe suksesin e tij të mëtejshëm edhe pas përfundimit të Ramazanit, si në rrafshin material edhe në atë shpirtëror. Tashmë në ditët e Bajramit, myslimanët peshojnë punët e kryera gjatë muajit të bekuar dhe sa kanë përfituar nga mundësitë e panumërta të këtij muaji për falje mëkatesh. Lutjet, adhurimet, sakrificat dhe ripërtëritja shpirtërore që përjetuam gjatë Ramazanit, na forcojnë e na motivojnë ta shohim festën e Fitër Bajramit si ditën e shpresave të reja, si ditën e kujtuarit dhe solidaritetit me njëri-tjetrin, si ditën e ripërtëritjes së vëllazërisë, miqësisë e dashurisë për njeriun.

Ditët e bajramit janë ditët e gëzimit të përbashkët me familjen, me të afërmit, fqinjët, shokët etj. Nisur nga kjo, bajrami duhet të shërbejë, për hir të Krijuesit, si pretekst dashurie, dhembshurie, mëshire dhe ndihmese për të gjithë

krijesat. Dimensionin social i kësaj feste është përkujdesja ndaj familjeve në nevojë. Këtë parim të lartë shoqëror e simbolizon urdhërimi i sadakasë së fitrit. Profeti Muhamed a.s. i porosiste shokët e tij që të mos i harrojnë të varfrit dhe nevojtarët. Kështu, myslimanët përpiqen që me anën e fitrave dhe llojeve të tjera të ndihmesës, të plotësojnë nevojat e të varfërve dhe jetimëve, që edhe ata të gëzojnë, sepse bajramet janë gëzimi i individit dhe i shoqërisë, janë hyrje në klimën e ndjeshmërisë, janë mundësia që të gjithë myslimanët ta ndjejnë veten vëllezër. Nuk mund të mendohet që të ketë gëzim dhe kënaqësi bajrami për ata që u kthejnë shpinën miqve, të afërmeve, të varfërve dhe vëllait të mbetur mënjane, sepse në porosinë profetike thuhet: "Veprimi më i dashur për Zotin, pas kryerjes së farzeve, është kur një mysliman e gëzon vëllain e tij".

Kjo festë e madhe e gëzimit, mëshirës, faljes, vëllazërisë e paqes, i pajis besimtarët me më shumë dashuri e respekt për njëri-tjetrin, me më shumë dëshirë e përkushtim për të shfaqur vlerat e mirësisë e të solidaritetit njerëzor, si dhe për të kryer vepra të dobishme në shërbim të vendit dhe të ardhmës së tij. Një fjalë e urtë thotë: "Ai që dëshiron të kuptojë moralin e një populli, duhet të studiojë festat e tij, të cilat paraqesin realitetin e ndjenjave e të traditave të trashëguara prej tij".

Festat islame i gjallërojnë më shumë besimtarët. Kjo shfaqet më tepër gjatë bajrameve, ku para se të lindë dielli i asaj dite, buzëqesh-jet pushtojnë fytyrat e të gjithë



njerëzve. Bajrami është një ditë gëzimi dhe plot hare, i cili fillon në mëngjes me tubimin e myslimanëve në një atmosferë vëllazërore e të gëzueshme, që t'ia dedikojnë lutjet dhe falënderimet e tyre Krijuesit të Lartësuar. Pjesëmarrja e tyre në namazin e Bajramit krijon një atmosferë të këndshme e gjallëruese për besimtarët. Të gjithë jemi dëshmitarë të atyre pamjeve madhështore që krijohen mëngjesin e faljes së bajramit, ku rrugët e qyteteve dhe të fshatrave tona mbushen plot me njerëz. Është një ardhje e vullnetshme, është një gëzim që buron nga thellësia e shpirtit të tyre. Profeti Muhamed (paqja dhe bekimi i Zotit qofshin mbi të) na këshillon se, në bajrame duhet të ketë gëzim e hare, me qëllim që të manifestohet uniteti, toleranca, forca e vëllazërimi. Të gjithëve u thoshte: "Në ditët e bajramit hahet, pihet dhe shkëmbehen vizita".

Myslimanët përjetojnë në këtë festë gëzimin dhe lumturinë e agjërimit të një muaji të plotë, për hir të Allahut, kapërcimin e vështirësive, kalitjen e durimit dhe çuarjen në vend të urdhrit të Zotit Fuqiplotë. Festimet gjatë këtyre ditëve na përkujtojnë ditët e së kaluarës së ndritshme islame dhe i inkurajojnë myslimanët për angazhime të mëtejshme, për detyra të reja dhe energji më të mëdha për ndërtimin e një të ardhme më të mirë e më të lumtur.

Është një pamje sa e rrallë aq edhe madhështore çasti i daljes së besimtarëve nga xhamitë. Urimi, "Nga mot gëzuar Ba-jramin!", përmbledh në vetvete forcën shpirtërore për të kryer detyrat e mëdha që kemi përpara në shërbim të

Islamit, fesë sonë të bukur. Ne kemi nevojë për të na u falur mëkatet, për të pasur shpirtin më të bardhë, që të duam njëri-tjetrin, prandaj urimi "Gëzuar Bajramin" është urimi më i bukur që buron nga thellësia e shpirtit.

Përjetimi i kësaj feste u jep myslimanëve një emocion të veçantë, një frymë të re, një zell të ri në përditshmërinë e tyre. Në këtë mënyrë, bajrami i jep indikacion të qartë myslimanit se me besim të fortë dhe qëndrueshmëri permanente, mund të arrijë kontroll të përkryer mbi veten dhe të vendosë baraspeshë ideale ndërmjet materiales dhe shpirtërores.

Le të shërbejnë këto ditë feste si një mundësi reflektimi për të gjithë, për të vlerësuar e forcuar harmoninë dhe bashkëjetesën fetare, si vlerën më të arriturë të shoqërisë shqiptare.

Duke e mbyllur me vargjet e një poeti arab, ju uroj nga mot gëzuar:

*"Nuk është Bajram për atë që vishet mirë,
Por për atë që nga mëkatet është i lirë.
Nuk është Bajram për atë që parfumohet,
Por për atë që kthesës shpirtërore i shtrohet,
Nuk është Bajram për atë që me kamje krenohet,
Por është Bajram për atë që nga mëkatet pendohet."*

EL-IHTIJARU LI TA'L'LI-L-MUHTARI

VEPËR THEMELTARE E FIKHUT HANEFI



Ky artikull analizon procesin, rëndësinë dhe ndikimin shkencor të përkthimit dhe botimit në gjuhën shqipe të veprës së njohur të jurisprudencës islame El-Ihtijaru li ta' lili-l-muhtari, të dijetarit klasik El-Imam ' Abdullah b. Ma' mud el-Mevsili el-Hanefi, një nga autoritetet më të spikatura të shkollës juridike hanefite. Në kontekstin e zhvillimit historik të literaturës islame ndër shqiptarë, përkthimi dhe botimi i kësaj vepre katër vëllimesh përfaqëson kulmimin e një përvojë të gjatë institucionale në përkthimin dhe publikimin e teksteve themelore fetare dhe akademike.

Punimi fokusohet në disa dimensione kryesore: së pari, në rolin historik dhe bashkëkohor të institucioneve islame shqiptare në zhvillimin e literaturës fetare në gjuhën shqipe, duke evidentuar se përkthimi i veprave klasike ka luajtur një funksion formues në ndërtimin e dijes, edukimit dhe orientimit fetar; së dyti, në përmbajtjen strukturore dhe tematike të veprës, e cila përfshin një spektër të gjerë dispozitash juridike, duke filluar nga adhurimet (pastërtia, namazi, zekati, agjërimi dhe haxhi), marrëdhëniet ekonomike dhe shoqërore (shitblerja, vakëfi, tregtia dhe ortakëria), e deri te çështjet penale, trashëgimore dhe ato që lidhen me luftën.

Një aspekt i veçantë i studimit i kushtohet analizës së procesit të punës kolektive, sfidave metodologjike, konsultimeve profesionale dhe bashkëpunimit ndërinstitucional të tri komuniteteve islame shqiptare në realizimin e projektit. Gjithashtu, trajtohet edhe arsyeimi

shkencor i disa ndërhyrjeve redaktoriale, siç është heqja e pjesëve që lidhen me robërinë, me qëllim shmangien e keqinterpretimeve në kontekstin bashkëkohor, duke ruajtur njëkohësisht vlerën historike dhe dokumentare të tekstit origjinal.

Rezultati përfundimtar përfaqëson një arritje të rëndësishme akademike dhe kulturore, duke kontribuar në modernizimin, sistemimin dhe vënien në dispozicion të një burimi themelor të së drejtës islame hanefite për studiues, juristë dhe institucione fetare shqiptare. Ky proces dëshmon kapacitetin intelektual dhe organizativ të institucioneve islame vendore, afirmon gjuhën shqipe si medium të denjë të literaturës klasike islame dhe e pozicionon atë si pjesëmarrëse aktive në diskursin bashkëkohor shkencor dhe fetar.

Institucionet bashkësive islame shqiptare, si bartëse dhe promovuese të qëndrueshme të fesë islame në hapësirën tonë kulturore, në kuadër të veprimtarisë së tyre themelore kanë pasur vazhdimisht edhe botimin e literaturës së përgjithshme islame. Kjo veprimtari ka filluar me botime që trajtojnë mësimet dhe njohuritë bazë të fesë islame dhe, me kalimin e kohës, është zgjeruar në botimin e veprave themelore të disiplinave të ndryshme shkencore islame.

Në këtë drejtim, duke marrë parasysh rrethanat historike dhe shoqërore nëpër të cilat kanë kaluar institucionet islame përgjatë më shumë se një shekulli, literatura islame e shkruar në gjuhën shqipe ka shënuar

arritje të rëndësishme dhe të dëshmuara. Këto arritje kulmojnë me përkthimin dhe botimin e Kuranit fisnik, si dhe të koleksioneve më të njohura të haditheve të Profetit Muhamed a.s., të pasuara nga vepra autoriale dhe përkthime në fushën e apologjetikës islame (akaidit), ekzegjezës kur'anore (tefsirit), jurisprudencës islame (fikhut), jetëshkrimit profetik (sires) dhe disiplinave të tjera, të destinuara si për besimtarët ashtu edhe për studiuesit.

Kjo veprimtari e gjerë dhe e qëndrueshme dëshmon jo vetëm për ecurinë e zhvillimit të literaturës islame në gjuhën shqipe, por edhe për kapacitetet intelektuale të institucioneve islame dhe për aftësinë e inteligjencës islame shqiptare që veprat klasike islame t'i përshtasë dhe t'i bëjë të qasshme në gjuhën shqipe, duke e përfshirë kështu këtë gjuhë në trashëgiminë e gjerë të literaturës islame botërore.

Në fakt, njohja e ulemasë shqiptare me literaturën klasike islame, si dhe transmetimi i saj te besimtarët përmes ligjëritit dhe mësimdhënies, është një proces i hershëm që daton që nga prania e Islamit në këto troje. Veprat e dijetarëve klasikë islamë janë studiuar ndër shekuj dhe kanë shërbyer si tekste bazë në institucionet arsimore islame, si mejtepet dhe medresetë. Për më tepër, ato kanë qenë objekt i komenteve, studimeve dhe trajtesave të ndryshme nga autorë vendas, fillimisht në gjuhë të huaja dhe, në shekullin e fundit, gjithnjë e më shumë edhe në gjuhën shqipe.

Në këtë vazhde zhvillimi intelektual dhe institucional, përkthimi dhe botimi në gjuhën shqipe i veprës El-Ihtijaru li ta' lili-l-muhtari paraqitet si projekt i përbashkët i tri komuniteteve islame shqiptare: Komunitetit Mysliman Shqiptar, Bashkësisë Islame të Kosovës dhe Bashkësisë Fetare Islame të Maqedonisë së Veriut. Kjo vepër, e autorit El-Imam ' Abdulluh b. Ma' mud el-Mevsili el- anefi, është një nga veprat më të njohura dhe më të përdorura të jurisprudencës islame hanefite dhe, pavarësisht kohës së hartimit të saj, vazhdon të ruajë rëndësinë dhe aktualitetin, veçanërisht për juristët dhe studiuesit e së drejtës islame.

Botimi i kësaj vepre kapitale në gjuhën shqipe u mundëson studiuesve dhe të interesuarve njohjen sistematike të fikhut islam, me theks të veçantë në drejtimin juridik hanefit, i cili historikisht dhe praktikisht është më i përhapuri në hapësirat shqiptare. Në thelb, kjo vepër u drejtohet kryesisht studiuesve dhe juristëve, më pak lexuesit të gjerë, për shkak të natyrës së saj teknike dhe trajtimit të çështjeve juridike përmes analizës së mendimeve të juristëve islamë dhe përzgjedhjes së qëndrimit të pranuar brenda shkollës hanefite.

Struktura e veprës pasqyrohet në katër vëllime. Vëllimi i parë trajton temat themelore të fikhut, duke filluar me kapitullin mbi pastërtinë, për të vazhduar me dispozitat e namazit dhe zekatit, dhe duke përmbyllur me trajtimin e detajuar të agjëritit dhe haxhit. Vëllimi i dytë përqendrohet në çështjet e marrëdhënieve ekonomike dhe shoqërore, përfshirë shitblerjen, tregtinë, kamatën,

kushtet për ushtrimin e funksionit të gjykatës, dëshminë, autorizimin, ortakërinë tregtare, vakëfin dhe dhurimet.

Në vëllimin e tretë trajtohen dispozitat që lidhen me bujqësinë, mbjellat dhe korrurat, si dhe çështjet e së drejtës familjare, përfshirë martesën, kurorëzimin, mehrin, shkuroëzimin dhe dënimet për shkelje morale, konsumimin e alkoolit, vjedhjen dhe grabitjen. Pas konsultimeve të gjera profesionale, nga ky vëllim janë hequr pjesë që lidhen me robërinë dhe skllavërinë, me qëllim shmangien e konfuzionit dhe keqinterpretimeve në kontekstin bashkëkohor, ndonëse këto dispozita mbeten të rëndësishme për kuptimin e realiteteve historike të kohës së autorit.

Vëllimi i katërt përfshin dispozitat që kanë të bëjnë me luftën dhe çështjet e ndërlidhura me të, gjuetinë, shpagimin, testamentin dhe trashëgiminë. Realizimi i këtij projekti madhor ka qenë rezultat i angazhimit të njohësve të shquar të fushës së fikhut, të cilët me profesionalizëm e kanë integruar këtë vepër në fondin e literaturës akademike shqiptare.

Ideja për përkthimin e kësaj vepre lindi si përgjigje ndaj nevojës për literaturë të standardizuar juridike islame, veçanërisht në kontekstin e fillimit të shekullit XXI, kur për shkak të zhvillimeve shoqërore dhe teknologjike, përmes internetit u përhapën mendime të ndryshme juridike, të panjohura më parë në traditën lokale, duke shkaktuar debate ndërmjet ulemasë dhe besimtarëve. Një shtysë shtesë ishte edhe fakti se një nga redaktorët kryesorë të botimit arab të kësaj vepre është dijetari i njohur me reputacion ndërkombëtar, Shejh Shu' ajb el-Arnaut.

Procesi i përkthimit dhe redaktimit, për shkak të kompleksitetit të veprës dhe natyrës së saj kolektive, u shoqërua me sfida të shumta, përfshirë edhe vështirësitë e bashkëpunimit gjatë pandemisë Covid-19. Megjithatë, projekti u përmbyll me sukses, duke dëshmuar angazhimin e qëndrueshëm të tri komuniteteve islame në realizimin e projekteve të përbashkëta shkencore dhe kulturore.

Merita të veçanta në realizimin e këtij projekti u takojnë përkthyesve prof. Jusuf Zimeri, prof. Nexhmi Maksuti, prof. Ekrem Maqedonci dhe prof. Driton Arifi, si dhe redaktorëve profesionalë Dorian Demetja, Andrin Rasha, Elton Karaj dhe Armand Asllani. Redaktimi përfundimtar dhe unifikimi terminologjik u realizua nga dr. Taxhedin Bislimi. Në fazën përgatitore dhe teknike kontribuan gjithashtu Ramadan Shkodra, Sadik Mehmeti, Nuhi Simnica, Bashkim Mehani dhe të tjerë, si dhe shtypshkronja "Aj-Graf".

Falënderime të veçanta u shprehën edhe për drejtuesit e tri komuniteteve islame: Bujar ef. Spahiu, Naim ef. Tërnavë dhe hfz. Shaqir ef. Fetahu, mbështetja e të cilëve ishte vendimtare për realizimin e këtij projekti. Në përmbyllje, ky botim paraqitet jo vetëm si një kontribut i rëndësishëm shkencor, por edhe si dëshmi e bashkëpunimit të suksesshëm ndër-institucional, me shpresën që ky bashkëpunim të vazhdojë edhe në fusha të tjera të studimeve islame.

Gruaja dhe Ramazani **Drita që agjëron në heshtje**

Ramazani nuk është thjesht një muaj agjërimi; ai është një ftesë hyjnore për t'u kthyer te vetja, për të heshtur zhurmat e botës dhe për të dëgjuar zërin e zemrës. Është muaji ku shpirti merr frymë më lirë, ku durimi bëhet forcë dhe ku çdo sakrificë kthehet në dritë.

Ramazani vjen çdo vit si një mysafir i bekuar, por në zemrën e gruas ai gjen një strehë të veçantë. Aty ku durimi është i përditshëm, sakrifica e heshtur dhe dashuria e pakushtëzuar, Ramazani nuk është vetëm muaj agjërimi, është muaj i ripërtëritjes së shpirtit.

Gruaja e pret Ramazanin me zemër të zgjuar. Ajo agjëron jo vetëm nga ushqimi dhe pija, por edhe nga fjalët e panevojshme, nga lodhja e ankesës, nga shpërqendrimi i zemrës. Agjërimi i saj është i dyfishtë: i trupit dhe i shpirtit. Ndërsa përgatit sofrën e iftarit, ajo përgatit edhe zemrën për falënderim. Ndërsa kujdeset për familjen, ajo kujdeset për lidhjen e saj me Allahun.

Ajo zgjohet para agimit për syfyr, edhe pse lodhja është e pranishme. Ajo falet në

heshtje, shpesh larg syve të të tjerëve, por shumë pranë Allahut.

Islami e ka nderuar gruan duke ia njohur vlerën e sakrificës së saj. Profeti Muhamedi (a.s.) na ka mësuar se veprat më të vogla, kur bëhen me sinqeritet, kanë peshë të madhe tek Allahu. Një iftar i përgatitur me dashuri, një fëmijë i qetësuar me fjalë të buta, një durim i ruajtur në çast lodhjeje – të gjitha këto janë adhurim në Ramazan.

Ramazani është muaji kur gruaja nuk kërkon të duket, por të ndriçojë. Drita e saj nuk është zhurmë, por qetësi. Nuk është shfaqje, por sinqeritet. Ajo është shtylla e shtëpisë dhe shpirti i Ramazanit brenda saj.

Në këtë muaj të bekuar, gruaja bëhet shembull i një besimi të gjallë: ajo që agjëron, lutet, duron dhe shpreson. Dhe Allahu, që nuk humb asnjë vepër, e di mirë se sa dritë lind nga një zemër gruaje që i është dorëzuar Atij. Çdo grua mund ta gjejë këtë dritë brenda saj, duke e bërë Ramazanin më të bukur për veten dhe për të tjerët.



Vlera dhe Rëndësia e Natës së Kadrut

Ndër qëllimet kryesore të Kuranit famëlartë është lidhja e njeriut me Zotin e tij. Këtë gjë Allahu xh.sh. na e mundëson edhe duke na treguar bujarinë dhe mëshirën e Tij të pakufijshme ndaj njerëzve. Kjo shfaqet qartë edhe në mundësitë e panumërta që Allahu sh.sh. ua jep njerëzve për tu kthyer drejt Tij. Njëra nga këto mundësi është edhe muaji i Ramazanit që Allahu xh.sh. na e mundëson çdo vit.

Muaji i Ramazanit zë një vend qendror në jetën shpirtërore të besimtarit mysliman. Ai është muaji i agjërimit, i reflektimit, i pastrimit moral dhe i afrimit me Zotin. Për të përfutur sa më shumë nga kjo mundësi e artë, Allahu xh.sh. në këtë muaj i prangos edhe shejtanët duke krijuar kushtet ideale që njeriu ta ndjejë sadopak bekimin dhe lumturinë që i jep lidhja me Zotin.

Brenda këtij muaji të bekuar, Allahu i Madhëruar ka zgjedhur një natë të veçantë, të cilën e ka dalluar nga të gjitha netët e tjera: Natën e Kadrut (Lejletul-Kadr).

Nata e Kadrut nuk është vetëm një moment kohor, por një ngjarje madhore me domethënie të thellë shpirtërore. Ajo përfaqëson kulmin e mëshirës hyjnore, natën e zbritjes së Kur'anit dhe një mundësi të jashtëzakonshme për falje, udhëzim dhe rinovim të jetës shpirtërore. Rëndësia e saj është aq e madhe, sa që Allahu i Madhëruar ia ka kushtuar një sure të plotë në Kur'anin famëlartë.

Kuptimi i Natës së Kadrut

Fjala "Kadr" në gjuhën arabe mbart disa kuptime që nxjerrin në pah thelbin e kësaj nate: vlerë e lartë, madhështi, nder dhe përcaktim hyjnor. Të gjitha këto kuptime ndërthuren për të shprehur statusin e veçantë të Natës së Kadrut mes gjithë

netëve të tjera të vitit.

Ajo quhet natë e vlerës, sepse adhurimi i kryer në të ka shpërblim të jashtëzakonshëm. Quhet natë e nderit, sepse në të zbresin engjëjt dhe mbizotëron paqja hyjnore. Po ashtu, konsiderohet natë e përcaktimit, pasi sipas traditës islame, në të shënohen vendime hyjnore që lidhen me rrjedhën e jetës njerëzore gjatë vitit që pason, gjithnjë në përputhje me dijen dhe urtësinë e Allahut.

Kur'ani e përmend këtë natë në mënyrë të drejtpërdrejtë:

"Ne e kemi zbritur atë (Kur'anin) në Natën e Kadrut." (Suretul-Kadr, 1)

Ky ajet përbën themelin e madhësisë së kësaj nate.

Zbritja e Kur'anit dhe dimensionet e udhëzimit

Ngjarja më e rëndësishme që lidhet me Natën e Kadrut është fillimi i zbritjes së Kur'anit fisnik. Kur'ani përfaqëson fjalën e Allahut dhe burimin kryesor të udhëzimit për njerëzimin. Me zbritjen e tij, filloi një epokë e re e ndërgjegjësimit shpirtëror, moral dhe shoqëror.

Kur'ani nuk është vetëm libër adhurimi, por udhërrëfyes për jetën, që synon të formësojë individin dhe shoqërinë mbi parimet e drejtësisë, mëshirës dhe përgjegjësisë. Prandaj, lidhja e Natës së Kadrut me Kur'anin e bën këtë natë simbol të dijes, reflektimit dhe përkushtimit ndaj vlerave hyjnore.

"Më e mirë se një mijë muaj" (Suretul-Kadr, 3)

Ky është një nga përshkrimet më domethënëse të Natës së Kadrut që gjendet në këtë ajet.

Ky pohim shpreh vlerën e jashtëzakonshme të kësaj nate në aspektin e shpërblimit. Një mijë muaj përfaqësojnë mbi



tetëdhjetë vite adhurimi, çka tregon se adhurimi i sinqertë në këtë natë tejkalon në vlerë adhurimin e një jete të tërë.

Ky është një manifestim i qartë i mëshirës së Allahut ndaj umetit të Muhamedit ﷺ, jetët e të cilit janë relativisht të shkurtra. Nata e Kadrit u jep besimtarëve mundësinë të arrijnë shkallë të larta shpërblimi dhe afrimi me Zotin brenda një kohe shumë të kufizuar.

Zbritja e engjëjve dhe paqja shpirtërore

Kur'ani e përshkruan Natën e Kadrit si natë në të cilën mbizotëron prania e engjëjllorë:

"Në të zbresin engjëjt dhe Shpirti (Xhibrili) me lejen e Zotit të tyre për çdo çështje." (Suretul-Kadr, 4)

Zbritja e engjëjve në numër të madh tregon përhapjen e mëshirës dhe bekimit hyjnor. Prania e engjëjllit Xhibril, bartësit të shpalljes, e nënvizon edhe më tej rëndësinë e kësaj nate.

Ajeti përmbyllës thekson:

"Paqe është ajo deri në agim." (Suretul-Kadr, 5)

Kjo paqe përfshin qetësinë e zemrave, sigurinë shpirtërore dhe ndjenjën e afrit me Allahun, duke e shndërruar këtë natë në një përjetim të thellë shpirtëror për besimtarin.

Është interesante ta mendosh se shenjat dalluese të Natës së Kadrit i kuptojmë në mëngjes, pra pasi të ketë kaluar nata! Kjo duket sikur na thotë se duhet të jemi gjithmonë në kërkim të mëshirës së Allahut që edhe ajo të na gjejë në Natën e Kadrit.

Falja dhe rinovimi i jetës shpirtërore

I Dërguari i Allahut ﷺ e ka theksuar rëndësinë e kësaj nate duke thënë se kush e kalon Natën e Kadrit në adhurim, me besim dhe shpresë për shpërblim, do t'i falen mëkatet e mëparshme.

Ky mesazh e paraqet Natën e Kadrit si një mundësi reale për pastrim shpirtëror, reflektim dhe fillim të ri, prandaj ai na ka nxitur që të bëjmë përpjekje gjatë gjithë muajit të Ramazanit në kërkim të shpërblimit të madh të kësaj nate.

Ajo fton besimtarin të rishikojë marrëdhënien e tij me Zotin, me veten dhe me të tjerët, duke e shndërruar këtë natë në një pikë kthese morale dhe shpirtërore. I gjithë muaji i Ramazanit dhe Nata e Kadrit që gjendet brenda tij, kanë për qëllim edukimin e njeriut me vlerat më të larta humane duke shpresuar pafundësisht tek shpërblimi i madh i Zotit.

Për ta përmbledhur mund të themi se Nata e Kadrit përfaqëson kulmin e madhështisë së Ramazanit dhe një nga dhuratat më të mëdha hyjnore për njerëzimin. Ajo bashkon në vetvete zbritjen e Kur'anit, shpërblimin e pakrahasueshëm, faljen e mëkateve dhe paqen shpirtërore.

Për besimtarin e ndërgjegjshëm, Nata e Kadrit nuk duhet të mbetet thjesht një natë e kërkuar në kalendar, por një përjetim i thellë që ndikon në jetën e tij të përditshme. Ajo është thirrje për reflektim, përmirësim dhe përkushtim ndaj vlerave që Kur'ani synon t'i ngulisë në jetën individuale dhe shoqërore që duhet ta shoqërojnë atë në çdo ditë të vitit.

Nata e Kadrit është një dhuratë e Zotit për ne që tregon mëshirën dhe bujarinë e Tij të pakufijshme ndaj nesh dhe kjo duhet të na shtojë edhe më shumë mirënjohjen dhe falënderimin ndaj Tij.

O Allah, na e mundëso ta arrijmë Natën e Kadrit!

A MUND TË MARRIN HOXHALLARËT DHURATA?



“Ti më dërgove mua një dhuratë dhe dëshiron të thyesh një rregullin tim tej mase të rëndësishëm! Unë nuk them: “Unë nuk i pranoj dhuratat nga ti ashtu siç nuk i pranoj nga Abdul-Mexhidi¹ dhe nga Abdurr-Rahmani², im vëlla dhe nipi, sepse meqenëse ti je më i përparuar se ata dhe më i afërt me shpirtin tim, atëherë edhe sikur të refuzoheshin dhuratat e çdo personi, dhurata jote nuk mund të refuzohet, vetëm këtë herë. Por në lidhje me këtë, unë do të të tregoj ty arsyen për rregullin tim. Ajo është siç vijon:

Saidi i Vjetër asnjëherë nuk ka pranuar dhurata. Ai preferonte më mirë vdekjen se sa të bëhej borxhli ndaj njerëzve. Ai kurrë nuk e theu këtë rregull të tijin, pavarësisht se vuante vështirësi e mundime të mëdha. Kjo veçori, e cila u la si një trashëgimi nga Saidi i Vjetër për këtë vëllain tuaj të mjerë, nuk është asketizëm, as një vetëmjaftueshmëri artificiale, e rreme, por ajo bazohet mbi “katër ose pesë arsye serioze.”

- E para: Njerëzit e çudhëzimit i akuzojnë dijetarët fetarë se e kanë marrë fenë si një mjet jetese. Ata i godasin këta në mënyrë të pandershme e të pabesë duke thënë: “Ata po i bëjnë diturinë dhe fenë si mjete jetese për vetveten.” Prandaj është e domosdoshme t’i përgënjeshtrojmë ata me vepra.

- Së dyti: Ne jemi të detyruar të ndjekim profetët, paqja qoftë mbi ta, në përhapjen e së vërtetës dhe në përcjelljen e saj. Kur’ani i Gjithurtë përmend se ata që e përhapin të vërtetën nuk kërkojnë shpërblim nga njerëzit dhe thonë: “Shpërblimi im është vetëm prej Allahut, Shpërblimi im është vetëm prej Allahut.”³ Fjalja tek sureja Jâsîn, “Ndiqui ata që nuk kërkojnë nga ju asnjë shpërblim (për vete) dhe që janë të udhëzuar drejt!”⁴, është më kuptimplota për sa ka të bëjë me këtë çështje tonën...

- E treta: Ashtu siç është shpjeguar në Fjalën e Parë, njeriu duhet të japë me Emrin e Allahut dhe të marrë me Emrin e Allahut xh.sh.. Ndërsa përgjithësisht, personi që jep është i pakujdesshëm dhe jep në emrin e vetes së tij dhe, në mënyrë të nënkuptuar i vendos të tjerët nën detyrim, ose ai që merr është i pavëmendshëm; ai ua jep falënderimet dhe lavdërimet, të cilat janë të posaçme për Mirëbërësin e Vërtetë, shkaqeve të jashtme, dhe gabon.

- E katërta: Mbështetja tek Allahu xh.sh., kënaqësia – mjaftueshmëria- dhe kursimi, janë një thesar i tillë dhe një pasuri saqë ato nuk mund të shkëmbehen e nuk kompensohen me ndonjë gjë tjetër. Unë nuk dëshiroj

1. Abdul-Mexhidi ishte vëllai më i vogël i Bediuzzamanit. Ishte mësues i shkencave fetare, në atë kohë myfti. Ai përktheu pjesë të Risale-i Nurit në arabisht, përktheu “Isharatul l’xhaz” dhe Methnevi Nurije nga arabishtja në Turqisht. Ai vdiq në vitin 1967. (Përkthyesi).

2. Abdurr-Rahmani ishte djali i vëllait më të madh të Bediuzzamanit. Ai u lind në Nurs në vitin 1903. Ishte djali i tij shpirtëror, student dhe asistent; ai iu bashkua xhaxhait të tij në Stamboll pas Luftës së Parë Botërore dhe botoi një biografi të shkurtër për të në atë kohë. Ai vdiq në vitin 1928.

3. Kur’an, 10: 72

4. Kur’an, 36: 21

të marrë gjëra nga njerëzit dhe ta mbyll atë thesar të pashtershëm dhe atë depo. Unë i jap qindra e mijëra falënderime Furnizuesit të Gjithëlavdishëm që qysh në fëmijërinë time Ai nuk më ka detyruar që të mbetem nën obligim e të jem i përlur e i poshtëruar. Duke u mbështetur në Bujarinë e Tij, unë shpresoj dhe i lutem Mëshirës së Tij që ta kaloj gjithashtu pjesën e mbetur të jetës sime në përputhje me këtë parim.

- E pesta: Si rezultat i shumë shenjave dhe eksperiencave që prej një viti ose dy, unë kam formuar një bindje të fortë se nuk jam i lejuar që të pranoj pasuri nga njerëzit dhe, në mënyrë të veçantë, dhurata nga të pasurit dhe zyrtarët. Disa nga ato më bëjnë të sëmure, madje ato janë bërë të jenë ashtu, bëhen të dëmshme me qëllim që unë të mos mund t’i haj. Ndonjëherë ato transformoheshin në një formë që më çrregullonin e më bënin keq. Kjo do të thotë se kjo gjendje në efekt është me qëllim që unë të mos marr pasuritë e njerëzve, pra është një ndalim për t’i marrë ato. Për më tepër, unë kam nevojë për vetmi, unë nuk mund të pres vizita të çdo personi vazhdimisht. Të pranuarit e dhuratave nga njerëzit bën të domosdoshme të marrësh në konsideratë ndjenjat e tyre dhe t’i pranosh ata në kohët që unë nuk dëshiroj dhe nuk e gjej atë të pëlqyeshme. Unë e gjej më të pëlqyeshme të ha një copë të vogël buke të thatë dhe të vesh rroba të arnuara në njëqind vende, dhe të shpëtoj nga shtirja e servilizmi. Është e papëlqyeshme për mua që të ha cilësinë më të mirë të bakllavasë dhe që të vesh rrobat më të mira nga duart e të tjerëve dhe të jem i obliguar për të marrë në konsideratë ndjenjat e tyre.

- E gjashta: Dhe arsyeja më e rëndësishme për vetëmjaftueshmërinë është ajo që thotë Ibnu Haxheri, dijetari më i besueshëm i shkollës së Sheriatit –sipas medhhebit tonë Shafii–, i cili shprehet: “Në qoftë se ti nuk je i drejtë, është haram të pranosh diçka që të dhurohet ty me nijetin e drejtësisë –e të qenit i drejtë.”⁵

Kështu, për shkak të lakmisë dhe ambicies, njerëzit e kësaj kohe e shesin dhuratën më të vogël shumë shtrenjtë. Ata e imagjinojnë një person që është për të të ardhur keq dhe gjynahqar si shembulli im, se është i drejtë dhe i japin atij një rriskë buke. Në qoftë se, ruajna Zot, unë e quaj veten time se jam i drejtë, kjo do të ishte një shenjë krenarie dhe vërteton mosekzistencën e drejtësisë. Në qoftë se unë nuk e quaj veten time të drejtë, nuk është e pranueshme t’i pranoj ato pasuri. Gjithashtu, të marrësh lëmosha dhe dhurata si shpërblim për veprat që orientohen drejt Ahiretit, do të thotë t’i harxhosh e t’i djegësh frutat e përjetshëm të Ahiretit në një formë kalimtare në dynja.

El Bakî huwel Bakî – I Qëndrueshmi i Vetëm, Ai është i Qëndrueshmi i Vetëm

(Risalei Nur/ Letra 2)

5. Shiko: Ibn Haxher el Hajthemi el Shafii Tuhfet el Muhtaxhli sherhil Minhaxh, I, 178.

DUAR QË ZGJATEN *drejt meje*



Teksa po ecja për në shkollë me mijëra duar zgjateshin drejt meje dhe kërkonin ndihmë duke më premtuar që Zoti do të më ndihmonte. Dhe mua rastësisht m'u kujtua një thënie "dora që jep është me e ngritur se ajo që merr." Nuk është se karakterizohem nga filantropizmi, jo për shkak se nuk dua, por dhe pse dëshiroj, nuk mund të ndihmoj çdo dorë që shtrihet drejt meje, por kurrsesi nuk mund t'i fyej këto duar, nuk mund të jem indiferente ndaj këtyre duarve që jetojnë pranë nesh, që jetojnë me ne çdo ditë. Nuk mund t'i ndihmoj të gjitha, por mund të ndihmoj një nga këto duar.

Nëse nuk do të mundem? Nëse nuk do të mundem do të prek një nga këto duar, do t'ju buzëqesh atyre, do të pyes pronarin e njërës nga këto duar nëse ndihet i uritur, i lodhur, i lumtur, i trishtuar, nëse ka nevojë të dëgjohet nga dikush, nëse ka nevojë të flasë me dikë, të qajë pranë dikujt, unë do të jem aty, gjatë gjithë kohës.

E keni vënë re sa të çuditshme janë këto duart njerëzore?! Ato mund të jenë të liga, mëkatore, mund të godasin një fëmijë, një grua, mund të bëjnë një mëkat, mund të vjedhin, të gënjejnë, madje disa duar dhe mund të vrasin. Disa duar janë më të gjalla, e të tjera të heshtura, disa duar të duket sikur tregojnë, të tjera sikur fshehin. Por duart janë dhe të shenjtë, veçanërisht kur luten... Eh sa vlerë të madhe ka një dorë e ngritur drejt Zotit. Duart mund të falin. Një dorë mund të përkëdhelë një fëmijë që ka nevojë, mund të mësojë gjera që fjalët si mësojnë dot. Mund të jetë kaq e heshtur, kaq e bukur, në atë mënyrën e saj perfekte, që vetëm Allahu diti ta krijojë.

Ajo që është e çuditshme është se njeriu i zakonshëm ka një paaftësi apo indiferencë kundrejt gjërave të një rëndësie shumë të madhe siç është "qenësia e Allahut dhe mënyra se si ai vepron" dhe një interes tepër të madh, por dhe të pakuptueshëm kundrejt gjërave më monotone dhe të përditshme.

Ndonjëherë mungon vetëm një detaj, një pjesëz apo copëz tejet e vogël për të zbuluar të vërtetën. Ndonjëherë mendojmë se diçka

është e vërtetë dhe më pas kuptojmë që ajo nuk ishte e tillë dhe herë të tjera ndërkohë që e marrim të vërtetën me vete ashtu si një shkop mbështetës, ajo thyhet dhe na lë në rrugë. E gjithë dilema e së vërtetës ndodh kryesisht për një arsye të vetme, sepse e vërteta gjendet para syve tanë, aty përballë nesh me forcën dhe potencën e saj. Ne naivët jemi kaq të verbër kundrejt të vërtetave të pastra si drita e diellit, që Allahu i madhërishtëm i serviri për ne ashtu në pjata të argjendta.


Ndonjëherë "vështirësitë e kësaj bote" na mveshin, egoizmi na përndjek dhe mania për pushtet na vihet pas. Si mundet një njeri të pretendojë përparim me të gjitha këto. Im atë ka një shprehje të cilën po e shoh të arsyeshme ta citoj "gjella pa kripë nuk do të hahej, por dhe më shumë kripë nuk do të hahej përsëri". Në fillim të them të drejtën s'është se e kuptova apo tentova ta kuptoj, por tani mendoj se ai donte të më mësonte që gjithçka ka një masë madje dhe dëshirat tona. A nuk është gjithçka e fundme? Ashtu si një ekuacion i cili duhet të ketë patjetër një zgjidhje, pasi nëse ti ke gjetur më shumë se një, do të thotë se ekuacioni yt është i pavlefshëm. Dhe kjo botë ka vetëm një zgjidhje, nuk mund të ketë dy apo tre, nuk mund të ketë shumë, ka vetëm një. A e keni zbuluar ju atë nëse jo duhet të zgjoheni dhe të gjeni zgjidhjen. Mos vallë jeni shumë vonë?

Dhe unë eci për në shkollë, i vërej ato duar të ftohta, që në vetvete kanë një nxehësi përvëluese, i vërej ato zëra të heshtur që në brendinë e tyre ulërasin. I shoh ato sy të skuqur nga lotët, vërej dhe ato këmbë të gjakosura nga i ftohti e dhimbja. I shoh dhe fytyrat që duket sikur kanë ardhur nga një botë tjetër të cilën unë nuk e njoh. I dëgjoj fjalët e tyre të përsëritura kaq e kaq herë: "Më jep diçka Zoti ta sjell të mbarë."

Këto duar që zgjaten drejt meje, s'po mund ti ndihmoj të gjitha ...

Të lutem Zoti im ndihmoji, pasi vetëm Ti mundesh.

Zekati dhe Sadakaja e Fitrit



Në një kohë kur shoqëritë përballen me pabarazi ekonomike, varfëri dhe dobësim të lidhjeve njerëzore, Islami ofron një sistem të drejtë dhe hyjnor që synon ruajtjen e dinjitetit të njeriut dhe ekuilibrin shoqëror. Ky sistem nuk mbështetet vetëm në ligje, por në edukimin e zemrës dhe ndërgjegjes njerëzore.

“Sot përsosa për ju fenë tuaj, plotësova ndaj jush dhuntinë Time dhe zgjodha për ju Islamin fe”. (Maide 3)

“Islami ndërtohet mbi Pesë shtylla: Dëshmia se nuk nka zot tjetër veç Allahut dhe se Muhamedi është rob dhe i Dërguar i Tij, falja e Namazit, dhënia e Zekatit, kryerja e Haxhit dhe agjërimi i Ramazanit”.

Një nga shtyllat më të rëndësishme të këtij sistemi është Zekati, një adhurim i cili lidh pasurinë me mëshirën, individin me shoqërinë dhe dynjanë me Ahiretin. Zekati nuk është thjesht një kontribut financiar, por një detyrim hyjnor që pastron pasurinë dhe shpirtin, duke e shndërruar besimtarin në burim të mirësisë dhe drejtësisë sociale.

S’ka dyshim se Zoti që krijoi gjithçka, është i Gjithëditur për gjithçka i nevojitet njeriut të krijuar prej Tij e që e caktoi si mëkëmbës të Tijin në tokë, si një rregullator dhe zbatues i vullnetit të Zotit.

Adhurimet në fenë Islame zënë një vend thelbësor, pasi janë qëllimi i krijimit të njeriut, ato garantojnë ruajtjen e lidhjeve me Zotin si dhe janë një garanci e ruajtjes së lidhjeve sociale. Çdo adhurim është një sprovë për njeriun dhe si i tillë duhet të konceptohet dhe përjetohet, e një ndër këto adhurime është dhe “Zekati” ose shtylla e tretë e Islamit.

Zekati është një ndër pesë shtyllat themelore të Islamit, ai është obligim për çdo Mysliman që plotëson kriteret e kërkuara, nëpërmjet tij synohet arritja e solidaritetit social dhe ekuilibrit ekonomik në shoqëri, pasi shpërndarja e tij bëhet tek kategori të përcaktuara të shtresave në nevojë.

Në aspektin gjuhësor, termi “Zekat” nënkupton pastrimin dhe shtimin e diçkaje, ndërsa sa i përket aspektit të terminologjisë Islame fjala “Zekat” nënkupton: “Nxjerrja e një sasive mallrash apo pasurish të caktuara nga Zoti, në sasi dhe afat të përcaktuar, e cila u jepet kategorive të përzgjedhura”.

Allahu i Madhëruar thotë në Kuranin Famëlartë:

Merr nga pasuria e tyre lëmoshë me të cilën t’i pastrosh ata dhe t’ua rrisësh veprat e mira (Et-teube 106).

Zekati dhe Sadakaja e Fitrit është ligjëruar

në vitin e dytë të hixhretit, përkatësisht pas obligimit të agjërit të Ramazanit.

Allahu ka përcaktuar dhe disa kriteret për obligueshmërinë e nxjerrjes së Zekatit, e ato janë:

-Të jetë Mysliman dhe i lirë.

-Të jetë pronar legjitim i pasurisë për të cilën do të japë zekatin.

-Ta ketë arritur Nisabin (Sasinë e kërkuar për nxjerrjen e Zekatit).

-Nisabi i caktuar të ketë kaluar Një vit Lunar.

Llojet e pasurive për të cilat kërkohet nxjerrja e Zekatit

1. Vlerat monetare: Ari, argjendi, kartëmonedhat.

2. Të korrat dhe frutat.

3. Asetet tregtare.

4. Bagëtitë: devetë, lopët dhe dhentë.

5. Mineralet e nxjerra nga toka.

Llogaritja e zekatit

Nisabi i zekatit për vlerat monetare është 85 gram ar, 595 gram argjend ose vlera e tyre dhe norma e detyrueshme për nxjerrjen e Zekatit është 2.5%.

Nisabi i të korrurave dhe frutave:

Nëse ujitja është realizuar natyralisht (pra ka patur reshje shiu), për të nxirret 10%.

Nëse ujitja është bërë në mënyrë artificiale atëherë tarifa e Zekatit është 5%.

Nisabi për dhentë fillon me plotësimin e 40 kokëve.

Nisabi për gjedhët fillon me plotësimin e 30 krerëve.

Nisabi për devetë fillon me plotësimin e 5 krerëve.

Kategoritë se kujt i jepet Zekati:

Allahu i Madhëruar ka specifikuar në librin e Tij kategoritë përfituese nga nxjerrja e Zekatit e ato janë:

1. Të varfërit: Ata që nuk kanë mjaftueshëm.

2. Të ngratët: Ata që nuk plotësojnë nevojat e tyre.

3. Ata që punojnë për mbledhjen e kësaj takse.

4. U jepet atyre që synon t’u fitosh zemrat: Të dobët në besim ose fillestarët.

5. Skllëvërve për t’i ndihmuar në fitimin e lirisë.

6. Të munduarve nga borxhet.

7. Atyre që luftojnë në rrugë të Allahut.

8. Udhëtarit nevojtar.

Përfitimet ekonomike dhe sociale të Zekatit.

1. Promovon solidaritetin social, duke ndihmuar në plotësimin e nevojave të të varfërve dhe duke zvogëluar hendekun midis të pasurve dhe të varfërve.

2. Mbështet zhvillimin ekonomik, duke kontribuar në lëvizjen e tregjeve dhe fuqisë blerëse nëpërmjet rishpërndarjes së pasurisë.

3. Redukton varfërinë dhe papunësinë duke u ofruar para atyre që kanë nevojë dhe duke u mundësuar të investojnë në projekte që ndihmojnë në vetë-mjaftueshmëri.

4. Pastron dhe shton pasurinë ashtu siç premtonte Profeti ynë i dashur ku thotë: "Nuk pakësohet pasuria nga bamirësia". (Transmeton Muslimi).

Përtej dimensionit ekonomik dhe social, Zekati ka një qëllim të thellë shpirtëror. Ai shërben si mjet për pastrimin e zemrës nga lakmia, egoizmi dhe lidhja e tepruar me pasurinë. Nëpërmjet Zekatit, besimtari edukohet me ndjenjën e falënderimit ndaj Allahut për begatitë që i janë dhënë dhe me ndërgjegjësimin se pasuria është amanet dhe jo pronë absolute.

Zekati forcon besimin (imanin), rrit ndjenjën e përgjegjësisë morale dhe e ndihmon njeriun të kuptojë se vlera e tij nuk matet me atë që zotëron, por me atë që jep për hir të Allahut. Ai e mëson besimtarin të shohë të varfrin jo me keqardhje, por me përgjegjësi, duke ndërtuar kështu ura mëshire, vëllazërie dhe solidariteti brenda shoqërisë.

Zekati i fitrit ose Sadaka Fitrit

Zekati i fitrit nënkupton një sadak obligative për çdo mysliman të cilën duhet ta japë para faljes së namazit të fitër bajramit.

Dallimi mes saj dhe zekatit apo sadakave të tjera është se ajo obligohet ndaj personave dhe jo kategorive të pasurisë sikurse nuk obligohet për nxjerrjen e saj nisabi ose që të kalojë 1 vit.

Synimet e Sadakasë së Fitrit

Sadakaja e Fitrit bazohet mbi hadithin e Ibn Abasit ku thotë: "I dërguari i Allahut e obligoi Sadakanë e Fitrit për agjëruesin si shlyerje e gabimeve dhe tejkalimeve, si ushqim për të varfërit, kush e kryen para faljes së namazit të Bajramit konsiderohet e pranuar, ndërsa kush e jep pas faljes së Bajramit është Sadaka e përgjithshme" (Transmeton Ebu Daudi).

• Pastrim dhe edukim për shpirtin e Agjëruesit, pastrim nga gabimet dhe edukim duke mos lejuar të lidhemi shpirtërisht me monetaren dhe

rritje e ndienjës së mëshirës karshi të tjerëve.

• Kompesim për mangësitë gjatë agjërimit por dhe shlyerje për lëshimet si: Thashethemet, përgojimi, kurioziteti i tepruar etj.

• Jetësim i solidaritetit me të tjerët dhe ndërtim të urave vëllazërore.

• Falenderim ndaj Allahut i Cili ia mundësoi Agjërimit e Ramazanit dhe lutje për pranim.

• Shprehje e gëzimit me festën e Bajramit, të qenit të barabartë në mënyrën e të festuarit dhe dhembshurinë që duhet të kemi ndaj njëri tjetrit.

Sadaka Fitri është obligim për çdo mysliman që ka mundësi materiale dhe posedon ushqim për vete dhe për familjen e tij në ditën e fitër Bajramit dhe jepet për çdo anëtar të familjes, përfshirë dhe fëmijët.

Sadakaja e Fitrit jepet para faljes së Bajramit dhe shpërndahet në ushqime bazë të përdorura në atë vend.

Ajo jepet një "Saa" për çdo anëtar dhe një "Saa" është i barabartë me 2.5-3 kg nga ushqimet bazë, sasi e cila mund të shtohet sipas dëshirës.

Kujt i jepet Sadakaja e Fitrit?


Pjesa dërrmuese e juristëve Islam janë të mendimit se shpërndarja e Sadaka Fitrit është njëjtë me kategoritë përfrituese të Zekatit, me një ndryshim se Juristët hanefitë janë të mendimit se sadakaja e Fitrit mund t'u jepet edhe nevojtarëve jomyslimanë. Duke vlerësuar faktin që ajo sepër për t'u ardhur në ndihmë.

Nuk munden që rrënjët (prindërit) t'u japin fëmijëve dhe anasjelltas.

Zekati është një nga shprehjet më të qarta të drejtësisë hyjnore dhe mëshirës islame. Ai nuk është një akt vullnetar bamirësie, por një obligim i caktuar nga Allahu për të ruajtur ekuilibrin shpirtëror dhe shoqëror. Nevojtarin nuk merr lëmshë, por të drejtën e tij, ndërsa pasanikut nuk i pakësohet pasuria, por i pastrohet dhe i bekohet ajo.

Në një botë ku pasuria shpesh shndërrohet në qëllim dhe jo në mjet, Zekati na rikujton se vlera e vërtetë e njeriut qëndron në bindjen ndaj Zotit dhe në shërbimin ndaj krijesave të Tij. Prandaj, kryerja e Zekatit me vetëdije, sinqeritet dhe përkushtim është dëshmi e një besimi të gjallë dhe një shoqërie që synon drejtësinë, mëshirën dhe paqen. Zekati nuk e varfëron pasurinë, por e pasuron shpirtin dhe e shpëton shoqërinë.

Zotin e lusim të na bëjë prej atyre që i kryejnë këto obligime me përkushtim e devocion dhe të na e bëjë jetën festë e bajram vazhdimisht.



Ademi (as)

si filloi jeta në Tokë

Çdo ngjarje ka kohën e vet që përjetohet. Dhe heroi kryesor është në përgjithësi një njeri. Zakonisht nisin njëllë, "Njëherë..., Në një vend të largët..., Para shumë kohësh...

Por kjo histori është disi ndryshe. Sepse zë fill atëherë kur njeriu ende nuk ishte krijuar. Kur nuk njihej as koncepti vend dhe as koncepti kohë.

Para se të ekzistonte koha... Para se të ekzistonte vendi.

Atëherë ekzistonte vetëm Zoti... Asgjë tjetër veç Tij.

Një qetësi dhe madhështi e pafund, një bukuri dhe lartësi e pakufi, që i përkiste vetëm Atij. Nuk ekzistonte as bota jonë, as hëna, as dielli dhe as yjet. Vetëm Drita e Tij.

Zoti (xh.sh.) dëshiroi të krijonte gjithësinë. Botën, diellin, hënën dhe yjet. Të krijonte detërat e kaltër, peshqit që notonin ndër ta, erërat që frynin, lulet ngjyra-ngjyra e fluturat që përkëdheleshin me ta, qiejt, retë e zogjtë që i jepnin gjallëri. Që bota të dukej më e bukur, më e gëzueshme.

Kur Zoti (xh.sh.) dëshiron të krijojë diçka, mafton që t'i thotë asaj: "bëhu!" Dhe ajo menjëherë krijohet. Zoti urdhëroi kozmosin, botën me të gjithë gjallesat që kishin brenda të krijoreshin për gjashtë ditë; kështu u krijua gjithësia. Po këto gjashtë ditë ishin krejt ndryshe nga ditët tona. Sepse dita jonë formohet me rrotullimin e tokës rreth boshtit të vet. Po atë kohë nuk kishte ende as tokë, as diell, e natyrisht edhe koncepti 'ditë' ishte ndryshe. Ne i quajmë ato ditë, "ditë hyjnore" dhe këto ditë kanë veçoritë e tyre. Ndoshta, po ta krahasonim një prej atyre ditëve me ditët e sotme, mund të jetë e barabarte me vite, ndoshta me shekuj.

Të vërtetën nuk e di askush, sepse këto gjëra u përkasin mistereve, të panjohurës për ne, asaj që e di vetëm Zoti e që i kapërcen kufijnjtë e mendjes njerëzore. Këto gjëra ne i njohim me aq sa na tregojnë Zoti (xh.sh.).

Zoti (xh.sh.) na shpjegon si i krijoi qiejt, tokën dhe gjithë gjallesat për gjashtë ditë dhe si i administron ato me forcën, fuqinë, pushtetin e Tij unik dhe se si çdo krijesë përkulet me nderim para forcës së Tij dhe mrekullohet para perfektshmërisë së Tij.

Çdo krijesë ia ka nevojën Atij për të mbijetuar, Ai nuk ka nevojë për asgjë. Sepse Ai është pronari i gjithçkaje, i çdo pasurie pafund.

Çdo krijesë në gjithësi pret para derës së bujarisë së Tij.

Zoti (xh.sh.) krijoi në qiej krijesa prej drite. I quajti 'engjëj'. Ata ishin më të bindurit, nuk dinin ç'ishte mosbindja, ishin gjithmonë të gatshëm për çdo urdhër, të dëgjueshëm për çdo fjalë.

Pastaj Zoti krijoi krijesa prej zjarri. I quajti 'xhinde', dhe i bëri të tillë që të mos shihen. I lejoi që të banonin në qiej e në tokë. Mes tyre kish edhe të mirë, edhe të pabindur.

Ndërkohë, Vullneti Hyjnor dëshiroi të krijonte Ademin, njeriun e parë!

Zoti u tha engjëjve:

"Do të krijoj në tokë një qenie të tillë, që do të jetë përfaqësuesi im atje."

Engjëjt kthyen sytë nga toka. Krijesat gjigande që jetonin atje ishin të tmerrshme, luftonin e derdhnin gjak. Pastaj kthyen sytë nga vetja. Ishin aq të mirë, aq të bindur! Gjithë kohën falenderonin Zotin, adhuronin pa pushim madhësinë e Tij dhe lavdëronin bukurinë e Tij. Engjëjt u çuditën. Edhe për të shuar kuriozitetin, edhe për të mësuar diçka të re nga dituria e pafund e Zotit, pyetën:

Prapë ndonjë tjetër që do derdhë gjak e do përhapë urrejtje? Po ja, na ke ne, që gjithë kohën të bindemi e të adhurojmë, që ta njohim pushtetin e bukurinë.

Engjëjt janë krijesa shumë të pastra dhe të singerta. Karakteri i tyre nuk i lejon të mendojnë asgjë të keqe. Mendonin se shkaku i vetëm i krijimit është adhurimi i Zotit e të bërit mirë. Dhe këtë e bënë fare mirë, ekzistenca e tyre mjaftonte për këtë. Dituria e tyre nuk e kalonte dot këtë kufi, nuk mund t'i mendonin dot misteret që qëndronin nën shkaqet e krijimit. Zoti u dha përgjigje engjëjve kështu: "Unë di atë që ju nuk e dini. E di unë arsyen e krijimit të Ademit. Ka shumë gjëra, shumë arsye krijimi që ju nuk mund t'i dini.

Ademi (as.) nuk do të ishte si gjallesat e tjera mbi tokë. Nuk do të derdhte gjak si ata. Por nuk do ishte

as si engjëjt. Ai ishte ndryshe, ishte një krijesë krejt e re. Ishte krijuar për të vërtetuar logjikën e pafund të Krijimit dhe të Krijuesit.

Zoti (xh.sh.) u shpjegoi engjëjve se si do të krijonte një njeri nga balta, si do t'i jepte atij formën më të bukur dhe si do i frynte pastaj shpirt nga shpirti i Vet. Ja, atëherë, ata duhet të përkuleshin para njeriut. Jo përkulje për adhurim, por përkulje për të shprehur respekt e admirim.

Krijuesi i Madh mori nga Toka një grusht dhé. Ai grusht dhé përmbante brenda çdo ngjyrë, të verdhë, të zezë, të bardhë. Ky ishte sekreti i ngjyrave të ndryshme të njerëzve.

Kur i shtoi dheut ujë dhe ai mori formën e argjilës së pastër, së cilës Zoti i dha formën e njeriut, pastaj i fryu nga fryma e Vet.

Kështu trupit të Ademit i erdhi jeta. Levizi... nisi të merrte frymë, hapi sytë dhe pa rreth vetes engjëjt të përkulur.

Syri i zuri njërin që nuk ishte përkulur, ishte në këmbë.

Ademi akoma nuk e njihte atë, as emrin nuk ia kishte mësuar ende.

Zoti pyeti krijesën që ishte në këmbë.

Po ti Iblis, përse nuk iu përkule kësaj krijese që e bëra me duart e mia?

Iblisi u përgjigj me zë të lehtë:

Po unë jam më lart nga ai. Atë e krijove nga balta, kurse mua më krijove nga zjarri.

Ik që këtej, të kam dëbuar! Dhe gjer Ditën e Gykimit, je i mallkuar! – i tha Zoti, Iblisit.

Me të vërtetë Iblisi u dëbua nga Vendi i Mëshirës Hyjnore, por nuk hoqi dorë nga mendjemadhësia e tij e nga inati karshi Ademit. Vazhdoi ta kërcënonte e t'i thërriste, duke i thënë se ai vetë ishte më i lartë.

Ademi (a.s.) vështroi me habi ato çka ndodhnin përreth tij dhe zemrën ia trazonin turli ndjenjash. Dashuri, frikë, tmerr. Një dashuri e madhe për Krijuesin e Tij që i kishte dhenë jetë dhe e kishte vënë në vendin më të lartë mes krijesave të tjera, duke i urdhëruar dhe engjëjt të përkuleshin para tij...

Frikë nga zemërimi hyjnor që kishte përzënë Iblisin nga Vendi i Mëshirës... Dhe tmerr, nga sjellja e Iblisit përballë tij, një qëndrim plot urrejtje, krenari dhe keqdashje që donte t'i bënte keq me çdo kusht Ademit...Ai ishte niohur me armikun e tij më të frikshëm që në çastet e para të jetës së tij. Iblisi ishte mes engjëjve kur ishin urdhëruar të përkuleshin. Por ai nuk ishte engjëll, ishte nga xhindet. Kur nuk iu bind urdhrit të Zotit, u dëbua. Kështu që Ademi (a.s.) e kuptoi se engjëjt ishin simbol i mirësisë. Iblisi: simbol i së keqes. Po ai vetë? Kë përfaqësonte ai? Ende nuk kishte asnjë njohuri mbi këtë gjë.

Pastaj Zoti (xh.sh.) ia shpjegoi atij të gjitha, qëllimin

e krijimit, misteret e konstruktit të tij dhe arsyet pse ishte më lart se krijesat e tjera. Ademi (a.s.) dëgjonte me vëmendje. Kështu Zoti i mësoi atij emrat e çdo sendi. I mësoi mënyrën për të emërtuar çdo gjë. E njohu me shprehjen e çdo krijese me simbole. Ç'ishte zogu, ç'ishte ylli, ç'ishte pema... Ademi mësoi emrat e gjërave. Por mos mendoni se ai mësoi vetëm emrat. Zoti i mësoi atij edhe njohuritë e tjera në lidhje me çdo gjë. Dhe misteri i krijimit të njeriut dhe të qenurit e tij më lart se krijesat e tjera ishte pikërisht dija.

Pasi i mësoi emrat dhe njohuritë mbi ekzistencën, Zoti u kthye nga engjëjt.

A m'i thoni dot emrat e këtyre gjërave?

Engjëjt panë me vëmendje ato që po u tregoheshin. Po nuk u gjenin dot emra.

Të penduar pohuan para Zotit që nuk i dinin dhe kërkuan falje për ngutjen.

– O Zoti ynë, o më i Larti! Pa dyshim që nuk ka as më të mrekullueshëm, as më të përsosur se Ti! Vërtet që gjithë dija jonë është veç ajo që na ke mësuar Ti! Edhe njëherë e kuptuam dhe e mësuam se njohuria dhe dija Jote është pafund dhe në çdo veprim ke logjikën dhe misterin që vetëm Ti e di.

Këtë herë Zoti u kthye nga Ademi:

– Adem, thuaja ti engjëjve emrat e këtyre sendeve. Ademi ua shpjegoi një nga një të gjitha. Së pari u tha emrin, pastaj u tregoi njohuritë e tjera që kishte për ta, ndërsa engjëjt dëgjonin të mrekulluar. Po, ai dinte, atij i ishte shpjeguar misteri i dijes. Kjo ishte veçoria e tij që e bënte më të nderuarin e qenieve, aftësia për të mësuar dhe për të shpjeguar.

Më në fund, engjëjt e kuptuan shumë mirë arsyen pse iu përkulën Ademit, si dhe aftësitë e tij që e bënin përfaqësues të Zotit në tokë. I aftë për të administruar botën dhe për të ndërtuar qytetërime të mëdha me diturinë që i ishte dhënë.

Ademi (a.s.) nisi të jetonte bashkë me engjëjt dhe shpesh u tregonte atyre mbi gjërat që kishte mësuar, por këto gjëra nuk i tërhiqnin dhe aq engjëjt, të cilët e kishin mendjen vetëm tek mirësia dhe adhurimi. Ademi e ndiente veten të vetmuar.

Një ditë, kur hapi sytë e u zgjua nga gjumi, vuri re një grua që i rrinte te koka. Ishte shumë e bukur, sytë i ndrisnin, ndërsa e vështroi Ademin (a.s.) plot dashuri.

– Po ti kush je? Ti nuk ishe këtu kur fjeta, – e pyeti Ademi.

– Jo, nuk isha.

– Por erdhe kur po flija?

– Po.

– Po nga erdhe? Ku ishe më parë?

– Me krijoi Zoti, kur ti po flije.

– Pse të krijoi?

– Sepse nuk duhet të rrish më vetëm. Sepse duhet të jemi të lumtur sëbashku.

– Faleminderit, o Zot! Vërtetë që kam qenë shumë vetëm.

Engjëjt iu afruan Ademit (a.s.) dhe e pyetën si quhej ajo grua.

– Hava, – iu përgjigj.

– Po pse Hava? Ç’do të thotë?

– Hava, sepse atë e krijoi Zoti nga trupi im. Hava do të thotë e gjallë, plot jetë ...

Zoti i vendosi Ademin dhe gruan e tij, Hava-në, në Xhenet.

Ata hynë përdore në atë vend të mrekullueshëm dhe jetuan atje ditët më të bukura të jetës së tyre; por edhe sproven më të dhimbshme.

Jeta në Xhenet ishte si një ëndërr e bukur.

Madje më e bukur se në endrra, sepse në endrra disa gjëra vetëm mund të dëshirohen, kurse në Xhenet bëhen realitet.

Gjithçka e mrekullueshme që mund t’i kalojë ndokujt nëpërmend, është në xhenet. Të ngrëna, të pira, banesa, rehati, dashuri, qetësi, lumturi. Krijesa nga më të bukurat. Panorama të mrekullueshme, aroma marramendëse...

Në mes të këtyre pasurive fantastike, Ademit iu mbush zemra me lumturi, aq më tepër që kishte edhe Havanë afër.

Ai nuk ishte më vetëm, me Havanë kalonin kohë shumë të bukura, bisedonin së bashku, shëtisnin së bashku, nuk kishin asnjë shqetësim, asnjë hall. Zogjtë e Xhenetit, me cicërimat e tyre të mrekullueshme, ujërat e kthjellët të lumenjve dhe gurgullima e tyre e këndshme, i qetësonin shpirtin, e lumturonin. Gjithësa ende nuk e dinte se ç’është dhembja.

Zoti (xh.sh.) u kish dhënë leje të shëtisnin në çdo vend të Xhenetit. Të shijonin çdo frut, çdo gjë që iu pëlqente. Përveç një peme.

– Në asnjë mënyrë nuk duhet t’i afroheni asaj peme! – u tha. – Përndryshe do t’i bëni keq vetvetes.

Ajo pemë duhet të ketë qenë pema e vuajtjes, sigurisht!

Si Havaja edhe Ademi, e dinin shumë mirë se nuk duhej t’i afroreshin asaj peme. Por edhe Ademi, fundja, ishte njeri. Me harrimin e vet, me hutimin, me gjendjen shpirtërore gjithnjë në ndryshim, me vullnet të dobët... Ndaj dhe Iblisi vendosi të përfitonte nga këto dobësi dhe me urretjen dhe smirën që i vlonte përbrenda, iu afrua Ademit.

“E di pse të është ndaluar t’i afroresh asaj peme? Sepse ajo pemë është pema e përjetësisë. Kush ha nga frutat e saj, bëhet i përjetshëm, i pavdekshëm,” – i pëshpëriste Ademit çdo ditë, çdo orë, duke u munduar t’ia merrte mendjen.

Ditët pasonin njera-tjetrën, Havaja dhe Ademi

nisën të mendonin gjithnjë e më shpesh për pemën e ndaluar. Derisa më në fund, vendosën ta hanin. Për momentin, harruan se shejtani ishte armiku i tyre më i madh. Ademi zgjati dorën te frutat e pemës, këputi një dhe ia dha Havasë. E para e hëngri ajo, pastaj edhe Ademi.

Sapo kapërdiu një copë nga fruti i ndaluar, Ademi ndjeu një shtrëngim në zemër. Trishtimi dhe pendesa e pushtuan përnjëherë. Ndërkohë gjithçka përreth humbi shkëlqimin, ndjenjat e mrekullueshme që kishte në shpirt u mpinë, bukuritë u zbehën dhe çdo anë u mbështoll nga një atmosferë zie.

Padashur pa trupin e vet... O Zot! Ishte lakuriq! Po ashtu edhe Havaja. Mes turpit e shqetësimit, nisën të mbuloreshin me gjethe që i keputën nga pemët.

Pas kësaj ngjarjeje, Zoti i urdhëroi të dilnin nga Xheneti.

Kështu Havaja dhe Ademi u zbritën në tokë!

Tashmë që nuk ishin më në Xhenet, Ademi (a.s.) rënkonte me pendesë, Havaja qante me dhembje. Më pas, Zoti (xh.sh.) e pranoi pendimin e tyre dhe i fali, por që tani e tutje, vendi i tyre do të ishte në tokë. Aty do të jetonin, aty do të vdisnin dhe në Xhenet do të mund të shkonin vetëm pas fundit të kësaj bote.

Kështu nisi për ta jeta në tokë. Punë pa fund, lodhje, stërmundime... Nuk kishte më rehati dhe pasuri si në Xhenet. Këtu shtëpinë e vet i duhej ta ndërtonte vetë, ushqimin duhej ta nxirrte vetë nga toka, i duhej të punonte e të grumbullonte. I duhej të qepte rroba për t’u mbrojtur prej kafshëve të egra. Më e rëndësishmja, i duhej të ruhej nga shejtani, pa e harruar për asnjë çast rrezikun që i kanosej prej tij. Ai kishte qenë shkaku që e kishte nxjerrë nga Xheneti, kështu që edhe në tokë nuk ai nuk do të rrinte duarkryq, do të gjente hile e mashtrime për t’i gënjyer ata e fëmijët e tyre, prandaj duhej të ishte i vëmendshëm çdo moment.

Që atëherë, beteja mes të mirës e të ligës do të vazhdohej pa ndërprerje. Disa do të zgjidhnin rrugën e Zotit, e nuk do të kishte për ta as kërcënim, as frikë. Disa do ndiqnin rrugën e Iblisit, duke mos iu bindur Zotit, derisa të përfundonin bashkë me Iblisin në Xhehenem.

Ademi (a.s.) i kuptoi këto gjëra ndërkohë që mundohej të përshtatej me kushtet e vështira të jetës në tokë dhe u mërzit shumë.

E vetmja gjë që ia lehtësonte pak hidhërimin, ishte ardhja e tij në tokë si mbret. Ai ishte mbreti, i pari. Ai do ta punonte i pari tokën, do të ndërtonte i pari, do të themelonte qytete e fshatra, do t’i rriteshin fëmijët, do t’i përhapeshin nga çdo anë, do e zhvillonin dhe më tepër jetesën dhe do t’ia shtonin bukurinë faqes së dheut. Jeta ishte një sprovë dhe toka-vendi ku do bëhej ajo sprovë.

Ademit (a.s.) i lindën shumë fëmijë e nipër. Ai vazhdimisht u shpjegonte atyre Zotin dhe i këshillonte të mos binin në kurthin e shejtanit. Të dilnin fitimtarë nga kjo botë do të thoshte të mundnin shejtanin, armikun e tyre të betuar.

Secilën herë, Havaja lindte binjakë. Njëri prej binjakëve ishte djalë, tjetra vajzë. Pastaj Ademi martonte vajzën e njërit bark me djalin e barkut tjetër, duke bërë të mundur kështu vazhdimin e jetës në tokë brenda njëfarë rregulli. Por këtë rregull nuk donte ta zbatonte Kabili. Ai donte të martohej me çdo kusht me binjaken e tij, edhe pse asaj i duhej të martohej me Habilin. Kabili këmbënguli aq shumë, sa Ademi i këshilloi që të bënin një flajm për Zotin. Me vajzën do të martohej ai të cilit do t'i pranohej kurban. Habili bëri kurban dashin e tij më të mirë, Kabili më të dobët.

Dhe Zoti pranoi kurbanin e Habilit.

Shejtani, duke marrë shkas nga dobësia e Kabil, vendosi t'i sulej. E mbushi me smirë dhe urrejtje, derisa e bëri armik me të vëllain.

Do të të vras! – i thirri Kabili i mashtruar Habil.

Habili ishte njeri shumë i mirë, i urtë dhe i moralshëm.

Edhe po ngrite dorë të më vrasësh, unë nuk do të përgjigjem, sepse unë kam frikë Zotin, nuk bëj krime! – u përgjigj i qetë Habili.

Por Iblisi po luante me Kabilin sipas qejfit të vet. Krimi i parë në botë, nga dora e Kabil do dilte...

Ishte një ditë e nxehtë. Habili kishte rënë për t'u çlodhur nën hijen e një peme, ku e kishte zënë një gjumë i thellë. Kabili doli heshturazi nga vendi ku qe fshehur, në dorë mbante një kockë të madhe të një kafshe të ngordhur. Iu afrua Habil dhe me gjithë fuqinë e qëllimit në kokë. Habilin e pafajshëm e mbuloi gjaku dhe menjëherë dha shpirt. Kabili, duke vrarë vëllain, kishte kryer edhe krimin e parë në faqe të dheut. Ishte bërë lojë e shejtanit. Megjithatë Ademi a kishte tërhequr vëmendjen me mijëra herë, duke i këshilluar që t'i ruheshin atij.

Kur pa trupin e pajetë të të vëllait, Kabili erdhi në vete. Sikur ishte zgjuar nga një makth! Habili shtrihej pa lëvizur. Kabili i thirri disa herë, e tundi dhe e shkundi që ta zgjonte, por më kot. Ishte tepër vonë. Një britmë tmerri i doli nga shpirti.

"Ç'bëra?", klithi. Por tashmë kjo nuk kishte asnjë vlerë.

I tronditur e i trembur, mendoi se ku mund ta fshihte kufomën.

Pas pak, klithma e një sorre, çau heshtjen. Kabili u kthye dhe pa një sorrë sterrë të zezë, që rrinte pranë një sorre të ngordhur. Siç duket, dhe ajo e ka vrarë të vëllain, mendoi Kabili. Sorra e zezë klithi edhe një herë tjetër, pastaj nisi të gërmoje dheun me sqep. Pasi hapi një gropë në tokë, e shtyu me këmbë sorrën e ngordhur dhe pastaj e mbylli sërish.

"Turp, as sa një sorrë nuk vlej", tha me vete Kabili dhe hapi edhe ai një gropë, ku varrosi të vëllain, pastaj iku larg, shumë larg.

Një ditë, profeti ynë, Muhamedi (a.s.), ishte ulur dhe po bisedonte me shokët e tij. Gjithmonë bisedat e tij ishin një burim dijesh dhe besimi për të gjithë. Kur e pyetën për krimin e parë mbi tokë, profeti (a.s.) tha kështu:

"Mekati i çdo krimi mbi tokë, i shkruhet njëkohësisht edhe Kabil, sepse krimin e parë mbi tokë e kreu ai."

Kur mësoi për krimin, Ademi (a.s.) u hidhërua jashtë mase.

Njërin bir e kishte humbur, kurse tjetri, me gjithë këshillat e tij të shumta, kishte rënë pre e shejtanit dhe e kishte humbur provimin në tokë. Por tani e kishte edhe më të qartë qëllimin e kësaj bote: 'Një luftë pa pushim me shejtanin, një përpjekje për Xhenetin e humbur.'

Koha rridhte...

Javët pasonin ditët, muajt javët, vitet muajt.

Një natë... Frynte një erë e rreptë. Gjethet e pemës që Ademi (a.s.) kishte mbjellë me duart e veta, u drodhën. Degët u përkulën gjër në ujërat e liqenit pranë. Sapo pushoi era, nga pema nisi të kullonte ujë, pikë-pikë.

Pemën e vjetër e kishte mundur trishtimi, dridhej me degët dhe gjethet e saja. Edhe yjet në qiell dridheshin. Hëna ishte zbehur shumë dhe shihte e përmallur nga qoshja e saj botën.

Rrezet e saj lajmëtare u derdhën mbi fusha, male, kodra, pemë, dhe u drodhën. Sepse gjithçka ishte mbështjellë në zi.

Trëshqitën në dhomën e Ademit.

Mbi fytyrën e tij ra argjendi i rrezeve të hënës. Ishte i lodhur, por i qetë, shumë i qetë. Një dhomë e thjeshtë, një shtrat me degë e gjethe dhe një burrë me mjekër të bardhë, fisnik, shumë fisnik. Perreth i qëndronin të bijtë. Dhe Ademi (a.s.) foli.

Foli për të gjithë pasardhësit e tij, për të gjithë ata që do të lindnin e për ata që ishin aty. "Vetëm një rrugë është për shpëtimin e njerëzimit. Vetëm një armë kemi për t'u mbrojtur nga shejtani, Besimin. Mesazhet që Zoti do t'i dërgojë njerëzimit me anë të profetëve."

Zoti nuk do ta braktiste njeriun në betejën e tij me shejtanin. Ai do t'i dërgonte njeriut profetë e të dërguar që do t'u tregojnë rrugën për në Xhenetin e humbur. Ndoshta me emra të ndryshëm, mrekulli e dhunti të ndryshme, veçori të ndryshme, por të gjithë të mbledhur rreth një të vërtete, besimi në një Zot të Vetëm.

Me të mbaruar porosinë, Ademi (a.s.) mbylli sytë e lodhur me ngadalë. Papritur, pa engjejt që e kishin rrethuar dhe e përshëndesnin. Mes tyre vuri re edhe engjëllin e vdekjes. Zemra i rrahu fort, buzëqeshi dhe ndjeu sërish aromën e Xhenetit që e kishte përfshirë të gjithin.

Letra e Ajnshtajnit për të
bijën, Lieserl:
Dashuria është gravitet



"Kur propozova teorinë e relativitetit shumë pak njerëz më kuptuan. Ajo çfarë do të zbuloj tani për njerëzimin gjithashtu do të pritet me keqkuptim dhe paragjykim.

Po të kërkoj të ruash letrat e mia për sa kohë të jetë e nevojshme: vite, dekada, derisa shoqëria të ketë bërë aq progres sa të arrijë të pranojë çfarë do të shpjegoj më poshtë.

Ekziston një forcë kaq e fuqishme sa deri sot shkenca nuk ka arritur t'i gjejë një shpjegim. Është një forcë që përfshin dhe i sundon të gjithë; që fshihet pas çdo fenomeni në univers. Kjo forcë është dashuria.

Kur shkencëtarët kërkonin për një teori të unifikuar të universit harruan më të fuqishmen forcë të padukshme. Dashuria është dritë që ndriçon ata që e japin dhe e marrin. Dashuria është gravitet, sepse i bën disa njerëz të tërhiqen nga të tjerë. Dashuria është pushtet, sepse shumëfishon më të mirën tonë dhe i bën njerëzit mos të humbasin në egoizmin e verbër.

Dashuria shpaloset dhe zbulon. Për dashurinë jetojmë dhe vdesim. Dashuria është Zoti dhe Zoti është dashuri.

Kjo forcë jep shpjegimin e gjithçkaje, i jep kuptim jetës. Është pikërisht ajo që kemi anashkaluar për kaq shumë kohë, mbase sepse kemi frikë nga dashuria, sepse është e vetmja energji në univers që njeriu nuk ka mësuar ende ta manipulojë.

Për t'i dhënë dashurisë vendin që meriton bëra një ndryshim të thjeshtë në ekuacionin tim më të famshëm. Nëse në vend të $E = mc^2$ të pranojmë se energjia që shëron botën mund të

përftohet nga shumëzimi i dashurisë me shpejtësinë e dritës në katror do të arrinim në përfundimin se dashuria është forca më e fuqishme që ekziston... sepse nuk njeh limite.

Pas dështimit të njerëzimit në shfrytëzimin e forcave të universit që na janë kthyer kundër është e rëndësishme që të ushqejmë një tjetër lloj energjie.

Nëse duam mbijetesën e specieve, nëse duam të gjejmë kuptimin e jetës, nëse duam të shpëtojmë botën dhe çdo gjallesë që e popullon atë, dashuria është përgjigjja e vetme.

Mbase nuk jemi ende gati të shpikim një bombë me dashuri, një pajisje të fuqishme që të shkatërrojë urrejtjen, egoizmin dhe lakminë që po gërryejnë planetin. Megjithatë, çdo individ mbart një "gjenerator" të vogël, por të fuqishëm dashurie, energjia e të cilit pret të çlirohet.

Atëherë kur të mësojmë të japim dhe marrim këtë energji universale, e dashura ime Lieserl, do të konfirmojmë se dashuria sundon mbi gjithçka; dashuria është e aftë të kapërcejë mbi çdo gjë, sepse dashuria është jetë.

Jam thellësisht i penduar që nuk kam qenë i aftë të shpreh çfarë kam në zemër, që ka rrahur për ty gjatë gjithë jetës sime. Mbase është vonë për të të kërkuar ndjesë. Por, meqë koha është relative, dua të të them se të dua. Falë teje kam gjetur përgjigjen themelore.

Babai yt,

Albert Einstein".

Përt Allahu mjafton



Ti!
 Ti që dje ishe vetëm një plan i bukur për të plotësuar
 një familje të re.
 Ti që dje nuk dije as të lidhje dy fjalë.
 Ti që dje shihje çdo gjë me sytë e çiltër të një fëmije
 të pafajshëm.
 Ti që dje ishe i pafuqishëm për të ecur me këmbët
 e tua.
 Ti që dje, me pretekstin se kishe frikë, nuk doje të
 largoheshe nga përqaftimi i ngrohtë i nënës.
 Ti që dje doje të ishe i lirë, i pavarur.
 Ti që dje nuk ishe i përgjegjshëm për ato që bëje.
 Ti që dje nuk doje t'ia dije nëse lëndoje njeri, nëse
 thyjeje një zemër apo vrisje një shpresë.
 Ti që dje gjeje shpëtim në mëkat, largoje problemet
 me një gotë alkool, gjeje ngushëllim në rrugë të
 gabuar.
 Ti që dje kujtoje se kishe çdo gjë dhe e ndjeje
 zemrën më bosh se vetë errësira.
 Ti që dje kujtoje se bota ishte jotja, por vetminë e
 kishe shoqëruese të shpirtit tënd të ngratë.
 Ti që dje kënaqeshe kur dikush derdhte lot, vuante...
 Ti që dje nuk pranoje fajin dhe gabimin nuk e quaje
 pjesë tënden.
 Ti që dje nuk prekeshe as nga e qara e një foshnjeje
 që kërkonte nënën e vet.
 Ti që dje përbuzje edhe njeriun e shkretë, që nga
 nevoja shtrinte dorën para çdo njeriu për të kërkuar
 lëmoshë për fëmijët e tij.
 Ti që dje braktise nënë e baba.
 Ti që bëre shtëpi tënden çdo vend jo të hijshëm.
 Ti që dje udhëhiqeshe nga egoja jote, ishe bërë rob
 i saj.
 Ti që dje mendoje për vete ...
 Ti...
 Ti që sot pendohesh për çdo sekondë të shkuar
 dëm.
 Ti që sot gjete Zotin Tënd.
 Ti që sot u ftove në shpëtim.
 Ti që sot u ftove në namaz.
 Ti që sot përulesh para Zotit Tënd.
 Ti që sot ecën në rrugë të drejtë.
 Ti që sot shndrit në fytyrë si një yll në tokë.
 Ti që sot dridhesh vetëm duke dëgjuar emrin e Tij të
 përmendet.

Ti që sot vrapon për në shtëpinë që gjithnjë ka qenë
 e jotja, për në xhami.
 Ti që sot gjen ngushëllim te namazi yt, te sexhdja
 jote, te Kur`ani Famëlartë.
 Ti që sot afrohesh çdo ditë me Zotin tënd me anë të
 lutjeve të tua.
 Ti që sot bën çdo gjë që Atij i pëlqen.
 Ti që sot i rri larg çdo gjëje që Ai nuk e quan të
 pëlqyeshme.
 Ti që sot mundohesh të ecësh në hapat e Profetit
 tënd të dashur (s.a.s).
 Ti që sot uth çdo pjesë toke ku nëna jote shkel.
 Ti që sot ha veten me dhembë për një namaz të
 vonuar.
 Ti që sot nuk ia fal vetes qoftë dhe një lot te
 derdhur nga syri i asaj që të dha jetë.
 Ti që sot prekesh nga një zog i vogël që nuk ngrihet
 dot në fluturim.
 Ti që sot ke dhembshuri për çdo gjë që sheh.
 Ti që sot falënderon Atë për çdo mirësi.
 Ti që sot u bekove me një foshnje që ta ka bërë
 zemrën më të butë se mëndafshi.
 Ti që sot nuk pret asgjë në këmbim, por mjaftohesh
 me një buzëqeshje.
 Ti që sot bën çdo gjë për hir të Allahut tënd (xh.xh).
 Ti që sot do të ndryshosh botën.
 Ti që sot arrin të shohësh mrekullitë që të rrethojnë.
 Ti që sot mësove ç'do të thotë të falësh.
 Ti që sot mësove të japësh mundësi të dyta.
 Ti që sot e ke zemrën plot.
 Ti që sot nuk ndjehesh asnjëherë vetëm.
 Ti që sot vlerëson çdo sekondë.
 Ti që sot lufton për një të nesërme më të mirë.
 Ti që sot punon për një jetë të pastajme.
 Ti që sot fle me emrin e Allahut dhe çohesh me
 falënderimin ndaj Tij.
 Ti që nesër do të jesh një shembull.
 Ti që nesër do të shpëtosh edhe të tjerë.
 Ti që nesër do t'i quash të gjithë motra e vëllezër.
 Sot është dita, nesër mund të jetë shumë vonë.
 Duaj, Fal, Dhuro, Bindu, Sakrifiko, Shpjego!
 Për ty Allahu mjafton...



DHURO

ZEKATIN, SADAKANË E FITRIT, FIDJEN ²⁰²⁶

Komuniteti Mysliman i Shqipërisë është organi zyrtar i përfaqësimit të myslimanëve në Shqipëri, dhe si i tillë, mbledh dhe shpërndan me përgjegjësi të plotë amanetin e besimtarëve dhe çdo qytetari.



NISABI ✓ 840.000 ALL ✓ 8.700 € ✓ 10.000 \$

SADAKAJA E FITRIT & FIDJA ✓ 400 ALL ✓ 4.5 € ✓ 5 \$



SKANO QR KODIN PËR TË DHURUAR
NËPËRMJET LLOGARIVE BANKARE



SKANO QR KODIN PËR TË
DHURUAR NËPËRMJET PAYPAL